



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, Programit Nacional për Zhvillim Ekonomik Lokal 2030, si dhe neneve 9 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 29.11.2024, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

VENDIM
PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË PËR ZHVILLIM EKONOMIK LOKAL TË
KOMUNËS SË LIPJANIT 2024-2029

Neni 1

MIRATOHET, Strategjia për zhvillim ekonomik lokal të Komunës së Lipjanit 2024-2029.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Strategjia për zhvillim ekonomik lokal në Komunën e Lipjanit 2024-2029.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim i Komunës së Lipjanit.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës .

Nr. 15-300/01-59396
Lipjan, më 29.11.2024

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi





KOMUNA E LIPJANIT

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL PËR KOMUNËN E LIPJANIT 2024-2029



Nëntor, 2024

Tabela e Përmbajtjes

Fjala hyrëse e Kryetarit të Komunës	6
1. Përmbledhja ekzekutive	7
2. Hyrja	8
3. Metodologjia	11
4. Misioni i Komunës së Lipjanit	12
5. Vizioni	12
6. Sfondi dhe analiza e gjendjes	13
6.1. Historiku i Komunës së Lipjanit	13
6.2. Historiku i zhvillimit ekonomik dhe industrial	13
6.3. Demografia e Komunës	15
6.4. Shtrirja gjeografike	18
6.5. Administrimi i Komunës	20
6.6. Ekonomia dhe punësimi	24
6.6.1. Gjendja e punësimit	24
6.6.2. Papunësia dhe sfidat e saj	26
6.6.3. Bizneset aktive	31
6.6.4. Zonat ekonomike	33
6.7. Arsimi	33
6.8. Infrastruktura	37
6.8.1. Rrugët	37
6.8.2. Rrugët hekurudhore	37
6.8.3. Furnizimi me energji elektrike	37
6.8.4. Telekomunikacioni	38
6.8.5. Kanalizimi dhe ndriçimi publik	38
6.8.6. Ujësjetësi dhe furnizimi me ujë	39
6.8.7. Planifikimi urban dhe hapësirat publike	39
6.8.8. Transporti publik dhe parkingjet publike	40
6.8.9. Menaxhimi i mbeturinave dhe shërbimet publike	40
6.9. Shëndetësia	41
6.9.1. Mirëqenia sociale	44
6.10. Bujqësia në Komunën e Lipjanit	49
6.10.1. Sipërfaqja e mbjellur dhe kulturat bujqësore	49

6.10.2. Sfidat e sektorit bujqësorë.....	52
6.11. Zhvillimi i turizmit dhe trashëgimia kulturore	53
6.11.1. Vendet turistike të zhvilluara dhe me potencial të zhvillimit.....	55
6.11.2. Shfaqjet dhe performancat artistike në shtëpinë e kulturës	55
6.11.3. Klubet sportive sipas llojit të sportit	56
6.12. SWOT analiza.....	57
7. Objektivat e Zhvillimit	60
7.1. Objektiva e Përgjithshme 1: Nxitja e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm dhe konkurrues.....	61
7.2. Objektiva e Përgjithshme 2: Përmirësimi i arsimit përmes zhvillimit të infrastrukturës, rritjes së cilësisë dhe sigurimit të qasjes për të gjithë.....	61
7.3. Objektiva e Përgjithshme 3: Përmirësimi i infrastrukturës publike në funksion të qytetarëve dhe bizneseve.....	62
7.4. Objektiva e Përgjithshme 4: Zhvillimi i bujqësisë përmes rritjes së prodhimit, përmirësimit të infrastrukturës dhe promovimit të zhvillimit rural të qëndrueshëm.	62
7.5. Objektiva e Përgjithshme 5: Zhvillimi i turizmit, trashëgimisë kulturore, mbrojtjes së mjedisit dhe infrastrukturës sportive.....	63
8. Burimet e Financimit	64
8.1. Financimet publike lokale	64
8.2. Financimet tjera.....	65
9. Monitorimi dhe Raportimi	66
10. Plani i Veprimit 2025-2027.....	67

Lista e figurave

Figura 1. Territori i Komunës së Lipjanit.....	19
Figura 2. Organogrami i administratës së Komunës së Lipjanit.....	21
Figura 3. Papunësia në Kosovë në tri vitet e fundit.....	27
Figura 4. Trendi i investimeve kapitale.....	65

Lista e tabelave

Tabela 1. Popullsia e përgjithshme sipas regjistrimit 2011 dhe 2024.....	15
Tabela 2. Popullsia në Komunën e Lipjanit sipas regjistrimit 2011 dhe 2024.....	16
Tabela 3. Popullsia sipas grupmoshave dhe llojit të vendbanimit 2011	17
Tabela 4. Përkatësia fetare e popullsisë në 2011.....	18
Tabela 5. Numri i të punësuarve në sektorin privat për tri vitet e kaluara.....	24
Tabela 6. Punëkërkues të regjistruar sipas regjioneve.....	27
Tabela 7. Popullsia ekonomikisht jo aktive.....	28
Tabela 8. Të rinj që nuk janë të punësuar, nuk ndjekin shkollimin ose trajnime (NEET)	29
Tabela 9. Shkallët e varësisë ekonomike 2021 - 2023	30
Tabela 10. Sektorët ekonomik.....	31
Tabela 11. Numri i Fëmijëve në Arsimin Parashkollor (2022-2023)	35
Tabela 12. Numri i Nxënësve në Arsimin Fillor dhe të Mesëm të Ulët (2022-2023)	35
Tabela 13. Nxënësit në Arsimin e Mesëm të Lartë (2022-2023)	35
Tabela 14. Numri i Fëmijëve/Nxënësve Sipas Gjinitive në të Gjitha Nivelet e Arsimit Parauniversitar (2022-2023).....	35
Tabela 15. Mësimdhënësit sipas Niveleve dhe Gjinitive – Parashkollor.....	36
Tabela 16. Mësimdhënësit e nivelit Parafillor/Fillor dhe i Mesëm i Ulët	36
Tabela 17. Mësimdhënësit në nivelin e Mesëm të Lartë.....	36
Tabela 18. Mësimdhënësit sipas Gjinitive (Totali).....	36
Tabela 19. Numri i vizitave në objektet shëndetësore.....	42
Tabela 20. Numri i shërbimeve të ofruara në vitin 2023	43
Tabela 21. Fëmijet pa përkujdesje familjare nën kujdestari dhe strehim familjar brenda familjes biologjike/2023	47
Tabela 22. Fëmijët në strehim familjar jashtë familjes biologjike/2023.....	47
Tabela 23. Përkrahja materiale e familjeve me fëmijë me aftësi të kufizuar.....	47
Tabela 24. Numri i familjeve dhe anëtarëve të familjes, të cilët kanë përfituar nga skema e ndihmës sociale.....	48
Tabela 25. Toka bujqësore sipas shfrytëzimit.....	49
Tabela 26. Sipërfaqet e mbjellura me kulturat lavértare	50
Tabela 27. Sipërfaqet e plantacioneve me pemë drufrutore	50
Tabela 28. Sipërfaqet e mbjellura me pemë të imta	51
Tabela 29. Mbështetja komunale për bujqësinë.....	51
Tabela 30. SWOT analiza për Komunën e Lipjanit – Zhvillimi ekonomik.....	57
Tabela 31. Plan buxhetor 2025 – 2027	64

Grupi punues për hartimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik

Përbërja e Grupit Punues është përcaktuar me vendimin e Kryetarit të Komunës me nr. 020/04-33502 të datës 12.07.2024, dhe është paraqitur në vijim:

1. Diamant Bytyqi, Nënkyetar i Komunës, Kryesues i grupit punues
2. Valon Pacolli, Drejtor i Drejtoratit për Ekonomi dhe Zhvillim, zëvendëskryesues
3. Shkëlzen Hajdini, Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale
4. Elmaze Behluli, Drejtorati i Administratës, anëtare
5. Sead Aliu, Drejtorati për Infrastrukturë, anëtar
6. Latif Ramadani, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtar
7. Anila Reqica, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtare
8. Rexhep Rexhepi, Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari, anëtar
9. Burim Rrustemi, Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, anëtar
10. Islam Kaleshi, Sektori për përfaqësim dhe çështje ligjore, anëtar
11. Linda Shahini, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim, anëtare
12. Fitore Buja, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim, anëtare
13. Brahim Duriqi, Drejtorati për Arsim, anëtar
14. Jetmir Bytyqi, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, anëtar
15. Armend Duriqi, Drejtorati për Gejodezi dhe Kadaster, anëtar
16. Bukuriye Zejnullahu, Zyrtare për konsultim me publikun, Zyra për Informim, anëtare
17. Fadil Sopa, Komuniteti i biznesit, anëtar
18. Leotrim Pajaziti, Shoqëria Civile, anëtar
19. Bafti Dogani, i propozuar nga MAPL në cilësi të konsulentit, anëtar

Përgjatë hartimit të strategjisë, Grupi Punues është mbështetur nga Kompania konsulente D&D Business Support Center SH.P.K me seli në Prishtinë.

Fjala hyrëse e Kryetarit të Komunës

Të nderuar qytetarë,

Komuna e Lipjanit, është e përkushtuar të krijoj kushte për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm dhe të integruar në zhvillimet rajonale – si pjesë e trekëndëshit të zhvillimit ekonomik të Kosovës.

Me këtë dokument strategjik është bërë analizimi i gjendjes së tanishme të zhvillimit në të gjitha fushat, janë adresuar sfidat si dhe janë identifikuar kapacitetet e përgjithshme dhe me ndikim esencial në zhvillimin ekonomik.

Mbi këtë bazë, janë përcaktuar objektivat strategjike zhvillimore në ekonomi, infrastrukturë publike dhe mjedis, arsim, kulturë, rini e sport etj. Vlerësojmë se objektivat zhvillimore të përcaktuara me këtë dokument, janë në trend me nevojat reale, me zhvillimet moderne dhe me perspektivë për të ardhmen. Përmes këtij dokumenti strategjik, hapen rrugë për investime të reja institucionale, si dhe krijohen mundësi partneriteti me qytetar, biznese dhe subjektet të tjera nga vendi dhe ato ndërkombëtare.

Me realizimin e objektivave zhvillimore, synojmë të arrijmë standardet më të larta të zhvillimit ekonomik dhe rritjen e nivelit të mirëqenies së qytetarëve në të gjitha fushat. Në funksion të kësaj, po ashtu kjo strategji është edhe një faktor shtesë dhe me rëndësi në qeverisjen efikase, të përgjegjshme, transparente dhe llogaridhënëse në fushat e ndërlidhura me zhvillimin ekonomik.

Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2024 -2029 është e harmonizuar me dokumentet e planifikimit hapësinor të Komunës dhe me Planin Kombëtar të Zhvillimit Ekonomik. Në hartimin e Strategjisë kanë marrë pjesë ekspert lokal, nga komuniteti i biznesit, shoqëria civile, mediat dhe institucione të tjera relevante. Në këtë rast shprehë mirënjohjen time për kontributin e tyre.

Ne besojmë , se zbatimi i kësaj Strategjie në bashkëveprim me qytetarët, komunitetin e biznesit dhe partnerët tjerë do të përshpejtoj rrugëtimin e zhvillimit ekonomik të Komunës së Lipjanit, për të arritur nivelin më të lartë të një Komune të zhvilluar dhe të preferuar për jetesë për të gjithë qytetarët.

Imri Ahmeti

1. Përmbledhja ekzekutive

Strategjia e Zhvillimit Ekonomik të Komunës së Lipjanit ka për qëllim vazhdimin e transformimit të komunës në një rajon me rritje të qëndrueshme dhe të balancuar ekonomike. Kjo përfshin përmirësimin e kushteve të jetesës dhe zhvillimin e sektorëve kryesorë përmes pesë objektivave kryesore.

Objektivat kryesore

1. **Zhvillimi ekonomik i qëndrueshëm dhe punësimi:** Strategjia synon nxitjen e investimeve dhe krijimin e vendeve të punës duke përfshirë sektorë kyç si industria, tregtia, bujqësia, dhe sektorët me investime të larta, duke ulur papunësinë dhe rritur punësimin gjithëpërfshirës.
2. **Zhvillimi i arsimit:** Synohet përmirësimi i cilësisë së arsimit për të gjithë qytetarët përmes ndërtimit dhe rinovimit të infrastrukturës arsimore, ngritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe gjithëpërfshirjes.
3. **Përmirësimi i infrastrukturës publike:** Ky objektivi përfshin përmirësimin e rrjetit rrugor, ndriçimit publik, si dhe zgjerimin e rrjeteve të ujësjellësit dhe kanalizimit, duke synuar rritjen e cilësisë së shërbimeve publike dhe të jetesës për qytetarët e komunës.
4. **Zhvillimi rural dhe bujqësor:** Fokusi është në rritjen e prodhimit bujqësor dhe zhvillimin e infrastrukturës për përpunimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore, si dhe përmirësimin e cilësisë së jetës në zonat rurale.
5. **Turizmi, trashëgimia kulturore dhe mbrojtja e mjedisit:** Strategjia përfshin ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe historike, si dhe zhvillimin e turizmit dhe infrastrukturës rekreative dhe sportive, për të tërhequr më shumë vizitorë dhe për të forcuar identitetin kulturor të komunës.

Strategjia e Zhvillimit Ekonomik të Komunës së Lipjanit është ndërtuar mbi një qasje metodologjike të mirëstudiuar, e cila përfshin analiza të thella dhe konsultime me aktorë kryesorë lokalë. Për shkak të mungesës së të dhënave të plota nga regjistrimi i fundit, janë zhvilluar intervista dhe diskutime me drejtues të komunës dhe sektorë të ndryshëm për të krijuar një pasqyrë reale të gjendjes ekonomike dhe sociale. Ky proces siguroi që strategjia të bazohet në informacion të besueshëm dhe të jetë e informuar nga një gamë e gjerë perspektivash.

2. Hyrja

Dokumenti Strategjik për Zhvillimin Ekonomik të Komunës së Lipjanit 2024-2029 është një vazhdimësi dhe avancim i strategjisë së mëparshme për zhvillim lokal të Komunës 2019-2023. Ky dokument reflekton përpjekjen serioze dhe të përkushtuar të Komunës për të siguruar një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm dhe të integruar. Në të janë përfshirë synime dhe objektiva të qarta që do të udhëheqin Lipjanin drejt një të ardhme më të avancuar.

Me këtë strategji, Komuna e Lipjanit synon të bëhet një komunë moderne dhe multifunksionale, e përkushtuar ndaj përmirësimit të cilësisë së jetës së qytetarëve përmes zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm, ekonomi qarkore që mundëson rritjen e mirëqenies sociale dhe ofrimin e shërbimeve publike cilësore. Një fokus i veçantë do të kushtohet aspekteve të barazisë gjinore dhe grupeve të cenuara sociale. Me këtë synojmë të krijojmë një mjedis të favorshëm për investime dhe inovacion, të përmirësojmë infrastrukturën dhe shërbimet shëndetësore, dhe të promovojmë arsimin, kulturën dhe sportin, duke siguruar një të ardhme më të mirë dhe të qëndrueshme për të gjithë banorët e Komunës.

Bashkërendimi me dokumentet tjera strategjike, politikat dhe akterët relevant qëndron në thelb të hartimit dhe më vonë në implementimin e kësaj strategjie. Andaj, identifikimi i objektivave dhe prioriteteve nacionale dhe Komunale është ndërlidhur me kujdes për të siguruar transparencë dhe koherencë në hartimin dhe zbatimin e strategjisë.

Hartimi i dokumentit bazohet në analizën e gjendjes aktuale të zhvillimit të Komunës së Lipjanit, duke marrë parasysh trendet zhvillimore, si dhe politikat dhe strategjitë nacionale të ndërlidhura. Orientimi i përgjithshëm për hartimin e strategjisë është udhëhequr nga Plani Kombëtar për Zhvillim 2030, Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2024-2026, Strategjinë për Vetëqeverisje Lokale 2016 - 2026. Për më tepër, planet komunale dhe sektoriale të Komunës së Lipjanit kanë luajtur një rol kyç në informimin dhe zhvillimin e këtij dokumenti, ndër ta më i rëndësishmi Draft Plani Zhvillimor Komunal 2023-2031 dhe Korniza Afatmesme Buxhetore 2025-2027.

Hartimi i Strategjisë është udhëhequr nga Grupi Punues i themeluar nga Kryetari i Komunës, përbërë nga një përzierje e gjerë ekspertësh dhe përfaqësuesish të komunitetit lokal dhe qëndror. Ky grup përfshin profesionistë nga fusha të ndryshme, përfshirë ekonominë, bujqësinë, arsimin, shëndetësinë dhe sektorët e tjerë kyç për

zhvillimin e komunës. Mbështetja dhe ekspertiza e ofruar nga Kompania Konsulente "D&D Business Support Center" me seli në Prishtinë ka qenë thelbësore në strukturimin dhe hartimin e strategjisë. Kjo qasje gjithëpërfshirëse siguron që strategjia të jetë e mirë menduar dhe të përfshijë nevojat dhe aspiratat e të gjitha grupeve të interesit në komunë.

Strategjitë relevante:

- **Plani Kombëtar i Zhvillimit 2030** përcakton vizionin dhe prioritetet për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe infrastrukturën cilësore në Kosovë. Dokumenti analizon gjendjen aktuale dhe ofron një plan veprimi për arritjen e qëllimeve në katër kategori kryesore: zhvillimi ekonomik dhe konkurrueshmëria, infrastruktura cilësore dhe e qëndrueshme, zhvillimi i njerëzve dhe kapaciteteve, dhe qeverisja e mirë dhe e përgjegjshme.
- **Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH) 2024-2026** analizon mjedisin makroekonomik në Kosovë dhe vendosë bazën për planifikimet buxhetore në përputhje me prioritetet strategjike të Qeverisë. Prioritetet përfshijnë mbështetjen e zhvillimit të industrisë dhe bizneseve, rritjen e investimeve në infrastrukturë, përmirësimin e shëndetit dhe arsimit, si dhe përmirësimin e mjedisit të jetesës. KASH është parakusht për rritje të qëndrueshme ekonomike, nxitjen e punësimit dhe mirëqenien e qytetarëve.
- **Strategjia për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026¹** analizon sfidat dhe mundësitë për vetëqeverisjen lokale në Kosovë, duke vendosur një vizion për ofrimin e shërbimeve më të mira komunale dhe rritjen e cilësisë së jetës së qytetarëve. Dokumenti paraqet objektiva dhe masa për përmirësimin e kornizës ligjore dhe institucionale, rritjen e kapaciteteve dhe resurseve, si dhe nxitjen e pjesëmarrjes aktive të qytetarëve. Kapacitetet dhe resurset aktuale të komunave janë të nivelit mesatar, me sfida financiare dhe mungesë burimesh. Masat përfshijnë investime në infrastrukturë, trajnime, dhe përmirësim të koordinimit ndërmjet komunave dhe institucioneve qeveritare, për të siguruar shërbime cilësore dhe efektive.
- **Programi Nacional për Zhvillim Ekonomik Lokal 2024 - 2030**, i aprovuar nga qeveria në tetor 2023, përcakton katër prioritete kryesore: ekonomi lokale konkurruese, punësim gjithëpërfshirës, infrastrukturë të përmirësuar dhe qeverisje efektive. Objektivat janë mbështetur me nën-objektiva që synojnë

¹ https://mapl.rks-gov.net/wp-content/uploads/2017/08/Strategjia_liber_tri-gjuhe_finale-2016.pdf

vendosjen e matësve dhe qasjeve për arritjen e këtyre qëllimeve deri në vitin 2030.

- **Draft Plani Zhvillimor Komunal 2023 – 2031**, objektivi kryesor është të sigurohet zhvillimi i qëndrueshëm dhe i balancuar i planifikimit hapësinor në territorin e Komunës së Lipjanit përmes qeverisjes së mirë, shfrytëzimit të përshtatshëm të tokës, mbrojtjes së mjedisit dhe ruajtjes së trashëgimisë kulturore. Plani përcakton shtyllat strategjike të zhvillimit si: ekonomi e qëndrueshme në kuadër të trekëndëshit të zhvillimit ekonomik të Kosovës; cilësi jetese dhe mjedis i pastër.
- **Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) 2025-2027**: është dokument planifikues buxhetor për periudhë tre vjeçare e cila përmban të gjitha projeksionet buxhetore në anën e të hyrave dhe të shpenzimeve. Dokumenti poashtu përcakton kategoritë buxhetore dhe fondet e alokuara nëpër kategori.
- **Planin Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore 2024-2026**: i cili propozon barazi në mes të gjinive dhe grupmoshave të ndryshme. Në aspektin ekonomik plani synon fuqizimin ekonomik, punësimin e denjë dhe fuqizimin e drejtësisë sociale në mes të gjinive në të gjithë diversitetin e tyre.

Legjislacioni relevant:

- Ligji për Vetëqeverisje Lokale/NR. 03/L-040.
- Statuti i Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095, 24.12.2021.
- Ligji për Financat e Pushtetit Lokal NR. 03/L-049, 2008.
- Ligji Nr. 04/L-045 Për Partneritete Publike Private.
- Ligji nr. 06/I-092 Për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

3. Metodologjia

Hartimi i strategjisë për zhvillimin ekonomik të Komunës së Lipjanit u bazua në një metodologji që përfshiu analiza të thelluara të të dhënave primare dhe sekondare, si dhe një proces gjithëpërfshirës të konsultimeve me aktorët kyç.

Në fazën e parë, u realizua një hulumtim i plotë mbi strategjitë ekzistuese në nivel komunal dhe qendror, duke përfshirë dokumente dhe plane relevante për zhvillimin ekonomik në nivel lokal dhe qendror. Ky proces përfshiu gjithashtu shqyrtimin e legjislacionit përkatës, si dhe analizën e statistikave zyrtare dhe burimeve të tjera sekondare të dhënash, të cilat ofruan një pasqyrë mbi gjendjen aktuale të ekonomisë lokale.

Një komponent thelbësor i metodologjisë ishte mbledhja e të dhënave primare përmes konsultimeve të strukturuar me aktorët kryesorë në komunë. Ky proces përfshiu intervista dhe diskutime të thelluara me përfaqësues nga bizneset lokale, sektori i organizatave joqeveritare (OJQ), si dhe drejtori të ndryshme brenda komunës. Këto konsultime kontribuan në identifikimin e sfidave konkrete dhe mundësive për zhvillim ekonomik, duke siguruar që strategjia të pasqyronte realitetet lokale dhe të adresonte nevojat aktuale të komunitetit.

Grupet punuese të udhëhequra nga grupi për strategji në Komunën e Lipjanit luajtën një rol qendror në organizimin dhe koordinimin e këtij procesi. Ato ndërthurën të dhënat primare dhe sekondare për të krijuar një analizë të integruar dhe të qëndrueshme, që mbështeti zhvillimin e strategjisë. Një fokus i veçantë iu kushtua edhe konsultimeve me qytetarët dhe palët e interesit përmes konsultimeve publike. Kjo siguroi që strategjia jo vetëm të pasqyron vizionin dhe prioritetet e administratës lokale, por edhe të jetë në përputhje me aspiratat dhe kërkesat e komunitetit më të gjerë.

Gjatë hartimit të strategjisë, sfida kryesore ka qenë mungesa e të dhënave të detajuara nga regjistrimi i fundit i popullsisë dhe ekonomive familjare për komunat. Kjo pengesë është tejkaluar përmes diskutimeve dhe intervistave me drejtorët dhe sektorët relevantë të Komunës, me synimin për të ofruar një pasqyrë sa më reale të gjendjes. Duke përdorur këtë qasje metodologjike, strategjia për zhvillim ekonomik është ndërtuar mbi një themel të fortë të informacioneve të besueshme dhe është formësuar nga një gamë e gjerë perspektivash të aktorëve kryesorë, përfshirë autoritetet lokale, bizneset dhe qytetarët e Lipjanit.

4. Misioni i Komunës së Lipjanit

Misioni i Komunës së Lipjanit është të përmirësojë kushtet e jetesës së qytetarëve përmes zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm. Përpjekjet tona do të përqendrohen në vazhdimin e transformimit ekonomik të Komunës në një qendër të zhvilluar ekonomikisht, me ekonominë në qendër të fokusit tonë. Krijimi i një mjedisi të favorshëm për rritjen e bizneseve dhe inovacionit, diversifikimi i ekonomisë duke eksploruar sektorë të rinj dhe të qëndrueshëm, të investojmë në arsim cilësor dhe në trajnimin e fuqisë punëtore për t'i përgatitur ata për sfidat e tregut modern të punës, dhe të sigurojmë mbështetjen e nevojshme për të gjithë banorët, duke përfshirë shërbime sociale dhe infrastrukturore të cilësisë së lartë.

5. Vizioni

Në vitin 2030, Komuna e Lipjanit synon të jetë një ndër Komunat lidere në zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm, ku qytetarët jetojnë me cilësi të lartë, gëzojnë punësim të sigurt dhe resurset komunale menaxhohen me kujdes, duke ruajtur dhe respektuar mjedisin.

Vlerat kyçe të komunës së Lipjanit janë: *barazia qytetare* (ofrimi i mundësive të barabartë për të gjithë qytetarët, në mënyrë që të arrihet potenciali i tyre i plotë), *llogaridhënia* (qeverisje komunale efikase dhe efektive), *komunikimi* (informimi dhe dëgjimi i qytetarëve dhe palëve tjera të interesit), *profesionalizmi* (kryerja e punëve dhe ofrimi i shërbimeve në mënyrë profesionale), *transparenca* (promovimi i punës së bazuar në transparencë) dhe respekti (trajtimi i secilës palë të interesit me dinjitet).

6. Sfondi dhe analiza e gjendjes

6.1. Historiku i Komunës së Lipjanit

Lipjani është një vendbanim me histori të gjatë, që daton nga koha Ilire dhe më vonë Romake, duke qenë pjesë e qytetit antik Ulpiana, i cili ndodhet rreth 10 km në verilindje. Gjatë periudhës romake, Lipjani ishte një vendbanim i vogël në rrugën drejt Lissum-it. Ky identifikim është konfirmuar nga zbulimet e gërmadhave të periudhës antike dhe bizantine, përfshirë themelet e një bazilike bizantine të zbuluar nën kishën ekzistuese në këtë zonë.

Me zhvillimin e industrisë minerare në Janjevë dhe rajonin përreth, Prishtina fitoi më shumë rëndësi, ndërsa Lipjani e humbi rolin e tij të mëparshëm dhe funksiononte si një vend tregtie lokal. Janjeva, përmendur për herë të parë në 1303, u zhvillua si një qendër industriale dhe tregtare gjatë shekujve XIV dhe XV. Në këtë periudhë, qyteti kishte kontakte me Republikën e Raguzës dhe, në 1665, u hap një nga shkollat e para në Kosovë, që ende ekziston sot.

Lipjani filloi të zhvillohej më tej në fund të shekullit XIX, me ndërtimin e hekurudhës (1873-1874), duke fituar një stacion hekurudhor dhe duke u bërë një qytezë në vitin 1920. Konkurrenca tregtare ndikoi në zhvillimin e qendrave si Mitrovica, Ferizaj dhe Lipjani, ndërsa qyteti filloi të shtrijë ndikimin e tij në rajon, përfshirë Drenicën e Epërme. Pozita gjeografike e Lipjanit ka pasur rëndësi për lidhjen e tij me qendrat më të mëdha si Prishtina, Gjakova dhe Prizreni.²

6.2. Historiku i zhvillimit ekonomik dhe industrial

Lipjani ka një traditë me të kaluar të gjatë industriale, e ndërtuar mbi pasuritë e tij nëntokësore dhe aktivitetin e ndërmarrjeve lokale. Shfrytëzimi i mineraleve si magneziti, nikel-kobalti dhe burimet për materialet ndërtimore ka qenë shtyllë e rëndësishme e zhvillimit industrial të Komunës. Në periudhën para viteve '90, ndërmarrësia lokale ka ndikuar në ngritjen e fabrikave dhe minierave, duke e bërë Lipjanin një pikë kyçe në industri. Këto ndërmarrje kanë ndihmuar në krijimin e një baze industriale të qëndrueshme në komunën e Lipjanit, duke ofruar mundësi punësimi dhe kontribuar në rritjen e ekonomisë lokale. Disa nga këto industri, si Miniera e Goleshit, Miniera e Babushit, janë të lidhura ngushtë me burimet natyrore të Kosovës dhe kanë pasur ndikim në zhvillimin e sektorëve të mineraleve, ndërsa të

² Komuna e Lipjanit, 2024. https://kk.rks-gov.net/lipjan/?page_id=200000106

tjera, si Fabrika e Coca-Coles dhe Termoventi, kanë ndihmuar në modernizimin e industrisë dhe avancimin e teknologjisë.

Miniera e magnezitit "Goleshi", e cila gjendet rrëzë malit Golesh, afër Aeroportit Ndërkombëtar "Adem Jashari", ishte një nga vendburimet më të rëndësishme të magnezitit në Ballkan dhe Evropë. Para mbylljes së saj në vitin 1999, kjo minierë ka prodhuar sasi të konsiderueshme të magnezitit. Nga viti 1964 deri më 1999, nga kjo minierë janë shfrytëzuar 4.6 milion ton xehe me përmbajtje të lartë të MgO (44.49%), SiO₂ (0.2-5.0%) dhe CaO (0.2-1.5%). Miniera u shfrytëzua me metoda nëntokësore, dhe mbetet një burim i rëndësishëm për industrinë minerare në të ardhmen.³

Poashtu, shfrytëzimi i nikelit dhe kobaltit ka një histori të gjatë në Kosovë, dhe Lipjani është i përfshirë në këtë industri përmes minierave të rajonit. Shfrytëzimi i nikelit filloi në vitin 1984 dhe deri më tani janë nxjerrë miliona ton xehe. Në kuadër të Feronikelit, minierat Medvec-Lipjan, ka qenë aktive në shfrytëzimin e xeheve me përmbajtje të nikelit dhe kobaltit. Në disa rajone të Komunes ka pasur iniciativa nga investitorët e huaj për hulumtime të rezervave të arit të cilat paraqesin një potencial të pashfrytëzuar deri më sot.⁴ Aktualisht, në Komunën e Lipjanit operojnë 18 operatorë aktivë që merren me nxjerrjen dhe shfrytëzimin e pasurive nëntokësore kryesisht me eksploatimin e gurit dhe zhavorit.

Industria e Lipjanit ka qenë e bazuar në një numër të fabrikave prodhuese dhe përpunuese që kanë operuar në sektorë të ndryshëm. Fabrika e Metalit "Metallaci" në Janjevë e cila ishte e specializuar në prodhimin e pajisjeve dhe produkteve metalike poashtu disa nga ndërmarrjet që patën impakt në zhvillim e traditës industriale dhe të cilat industri ishin unike në nivel nacional.

Miniera e Babushit ka qenë një nga ndërmarrjet kryesore të industrisë minerale të Kosovës, duke nxjerrë lëndë të para si qymyr dhe minerale të tjera. Ajo ka kontribuar në zhvillimin ekonomik të Lipjanit, duke ofruar mundësi pune dhe mbështetur furnizimin me energji dhe materiale për industrinë e Kosovës.

Fabrika e pijeve Coca-Cola në Lipjan poashtu ka pasur ndikim të madh në industrinë e pijeve dhe ushqimit, duke krijuar mundësi punësimi dhe forcuar lidhjet ekonomike ndërkombëtare. Ajo gjithashtu ka investuar në avancimin e teknologjisë dhe standardeve të cilësisë, duke përmirësuar industrinë ushqimore dhe pijeve.

³ Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, 2024. <https://kosovo-mining.org/resurset-minerale/statistika/>

⁴ <https://sot.com.al/aktualitet/ar-ne-nentoken-e-prishtines-ja-3-zonat-ku-pritet-te-hapen-miniera-i609462/>

Fabrika e Letrës ka krijuar një zinxhir të prodhimit për letrën dhe produkte të tjera, duke ofruar mundësi pune për shumë banorë të Lipjanit.

Termoventi ka luajtur një rol të rëndësishëm në industrinë e energjisë dhe ngrohjes, duke prodhuar pjese për sisteme ngrohjeje dhe energji. Kjo ka ndihmuar në avancimin e infrastrukturës dhe në mbrojtjen e mjedisit përmes përdorimit të burimeve energjetike më të pastra.

Kooperativa bujqësore ka kontribuar në zhvillimin e bujqësisë lokale dhe prodhimin e produkteve bujqësore, duke siguruar ushqim për tregun vendas dhe për eksport, si dhe duke mbështetur fermerët e vegjël dhe punësimin e tyre.

Ferma e Pulave ka kultivuar pula dhe vezë. Ajo gjithashtu ka ofruar mundësi punësimi dhe mbështetje për sektorin bujqësor dhe agro-industrinë.

Megjithatë, zhvillimi industrial në Lipjan ka hasur edhe në sfida, të tilla si mungesa e investimeve të mëdha, sidomos përgjatë viteve 90ta dhe në vitet e para të pas periudhës së luftës dhe nevoja për përmirësimin e infrastrukturës dhe shkathtësive të punëtorëve. Pavarësisht sfidave, këto ndërmarrje kanë luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin e Lipjanit në një qendër industriale të rëndësishme në Kosovë.

6.3. Demografia e Komunës

Gjendja dhe trendet demografike në Komunën e Lipjanit bazohen kryesisht në të dhënat e regjistrimit të popullsisë të vitit 2011 dhe ato të fundit (preliminare) të vitit 2024. Për të mundësuar një paraqitje dhe analizë më të plotë, në vijim po paraqesim popullsinë e përgjithshme dhe trendet e lëvizjeve në dekadën e fundi, si në vijim:

Tabela 1. Popullsia e përgjithshme sipas regjistrimit 2011 dhe 2024

	2011	2024	Trendi
Popullsia gjithsej	1,739,825	1,586,659	Ulje
Meshkuj	875,900	795,046	Ulje
Femra	863,925	791,614	Ulje
Mesatarja e moshës	29.97	34.82	Rritje

Burimi: ASK, 2024

Në periudhën nga 2011 deri në 2024, numri i përgjithshëm i popullsisë në nivel vendi, ka shënuar një rënie prej rreth 153,166 individësh.⁵ Kjo ulje në popullsi mund të jetë rezultat i disa faktorëve si emigrimi, rënia e normës së lindjeve, apo ndryshimet në politikat e planifikimit familjar.

⁵ Ashtu si në vitin 2011, në katër komunat veriore të Kosovës: Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë, pati një bojkotim të madh të procesit të regjistrimit, edhe pse disa banorë u regjistruan.

Sa i takon strukturës gjinore, numri i meshkujve ka rënë me 80,854 individë dhe numri i femrave ka rënë me 72,311 individë. Këto ulje të popullsisë për të dy gjinitë janë të ngjashme dhe reflektojnë trendin e përgjithshëm të zvogëlimit të popullsisë. Faktorët që kontribuojnë në këtë mund të përfshijnë emigrimin e të rinjve në kërkim të mundësive më të mira jashtë vendit dhe rënien e normës së lindjeve.

Në anën tjetër, mesatarja e moshës është rritur nga 29.97 vjeç në 34.82 vjeç. Kjo tregon një trend gradual të plakjes së popullsisë, që mund të jetë pasojë e rënies së lindshmërisë dhe emigrimit të të rinjve. Një popullsi në plakje mund të ketë implikime të rëndësishme për tregun e punës, shërbimet shëndetësore dhe politikat sociale.

Trende të ngjashme vërehen edhe në Komunën e Lipjanit me të dhënat e paraqitura në tabelën në vijim:

Tabela 2. Popullsia në Komunën e Lipjanit sipas regjistrimit 2011 dhe 2024

	2011	2024	Trendi
Popullsia gjithsej	57,605	54,974	Ulje
Meshkuj	29,320	27,862	Ulje
Femra	28,285	27,113	Ulje

Burimi: ASK, 2024 (Te dhënat nga regjistrimi preliminar i popullsisë 2024).

Sipas të dhënave paraprake të regjistrimit 2024,⁶ Komuna e Lipjanit bënë pjesë në komunat ku ka pasur ulje të numrit të popullsisë përgjatë viteve të fundit, me rreth 4.5% - 2,631 banorë më pak se në vitin 2011 (1,458 meshkuj dhe 1,172 femra). Në këtë kuadër Komuna e Lipjanit ka gjithsej 11,728 ekonomi familjare me një mesatare prej 4.7 anëtarësh.⁷ Trendi i zvogëlimit të numrit të përgjithshëm të popullsisë dhe rritja e moshës mesatare, reflekton sfida të caktuara për zhvillimin ekonomik dhe social të komunës. Komuna e Lipjanit duhet të adresojë këto sfida përmes politikave të favorshme për rritjen e natalitetit, krijimin e mundësive për të rinjtë brenda vendit dhe përmirësimin e kushteve të jetesës për të parandaluar emigrimin.

Kjo strukturë demografike ngre disa çështje të rëndësishme për analizë. Së pari, pabarazia në përqendrimin e popullsisë midis zonave urbane dhe rurale mund të

⁶ Të dhënat detale nga regjistrimi i popullsisë ende nuk janë publikuar dhe kjo paraqet një vështirësi në ofrimin e një analize të plotë demografike.

⁷ ASK, 2024. Rezultatet preliminare të regjistrimit të popullsisë. <https://askapi.rks-gov.net/Custom/1d268e37-5934-4bd5-bbd1-34a9965cff92.pdf>

reflektojnë në një nivel të ndryshëm zhvillimi ekonomik dhe infrastrukturor mes këtyre zonave. Zona urbane ofron më shumë mundësi për punësim, arsimim dhe shërbime, duke u bërë një tërheqës për migrim të brendshëm, ndërsa zonat rurale mbeten kryesisht të përkushtuara ndaj bujqësisë dhe aktiviteteve tradicionale.

Së dyti, ky raport demografik gjithashtu sugjeron që investimet dhe politikat e zhvillimit të infrastrukturës duhet të vazhdojnë të fokusohen në përmirësimin e kushteve të jetesës në zonat rurale për të balancuar zhvillimin dhe për të shmangur pabarazitë sociale dhe ekonomike mes këtyre dy zonave.

Vlen të theksohet se politikat dhe strategjitë e hartuara deri më tani janë bazuar kryesisht në të dhëna dhe vlerësime të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, të cilat kanë sugjeruar një trend në rritje të popullsisë që prej regjistrimit të vitit 2011. Megjithatë, të dhënat paraprake të regjistrimit të bërë në vitin 2024 sinjalizojnë një rënie të numrit të banorëve të Kosovës krahasuar me vitin 2011. Kjo kërkon kujdes të shtuar në planifikimet e politikave dhe orientimin e resurseve kombëtare dhe komunale, përfshirë edhe Komunën e Lipjanit. Planifikimet dhe strategjitë duhet të bazohen në trendin aktual dhe në projeksionet demografike, gjë e cila paraqet një sfidë më vete. Për më tepër edhe strukturën moshore të popullsisë nuk po e bazojmë në shënimet e deritashme meqë vlerësimet duken se kanë qenë të pasakta.

Tabela 3. Popullsia sipas grupmoshave dhe llojit të vendbanimit 2011

	Gjithsej	Urban	Rural
0-9	11,142	1,274	9,868
10-19	11,757	1,282	10,475
20-29	10,141	1,258	8,883
30-39	8,378	991	7,387
40-49	6,525	807	5,718
50-59	4,519	633	3,886
60-69	3,030	380	2,650
70-79	1,606	191	1,415
80+	507	54	453

Burimi: ASK, 2011

Në vitin 2011, popullsia totale e Lipjanit arriti në 57,605 banorë, ku 6,870 prej tyre jetonin në zonën urbane, ndërsa pjesa dërrmuese, 50,735 banorë, ishin të shpërndarë në zonat rurale. Ky raport ka ndikim të drejtpërdrejtë në planifikimin urbanistik dhe strategjitë e zhvillimit të qëndrueshëm të komunës, pasi kërkohet një qasje më gjithëpërfshirëse që të përfshijë zhvillimin e harmonizuar të zonave rurale dhe urbane.

Duke analizuar të dhënat e popullsisë për vitin 2011 sipas grupmoshave, vërehet së grupmoshat më të reja (0-19 vjeç) përbëjnë shumicën, me 22,899 banorë, që tregojnë një popullsi të re dhe potencial për rritje demografike. Grupmosha 20-29 vjeç përfshin 10,141 banorë, të cilët janë kryesisht aktivë ekonomikisht. Grupmoshat e mesme (30-49 vjeç) përbëjnë 14,903 banorë dhe janë në fazën kulmore të aktivitetit ekonomik dhe familjar. Grupmoshat e mesme të vjetra (50-69 vjeç) përfshijnë 7,549 banorë, duke treguar një segment të konsiderueshëm afër pensionit. Ndërsa grupmoshat më të moshuara (70+ vjeç) përbëjnë 2,113 banorë, të cilët kërkojnë shërbime të specializuara shëndetësore dhe sociale. Kjo strukturë demografike tregon një komunitet dinamik me nevoja të ndryshme, që kërkon planifikim të kujdesshëm të politikave dhe strategjive për të mbështetur të gjitha grupmoshat. Mangësia e kësaj analize konsiston në mungesën e të dhënave për grupmoshat në Komunën e Lipjanit pas regjistrimit të fundit, të cilat ende nuk janë bërë publike.

Ajo që dihet tashme, regjistrimi i fundit i popullsisë ka nxjerrë në pah trendin e plakjes graduale të popullsisë dhe shtim të jetëgjatësisë mesatare. Ky trend duhet të vëzhgohet me kujdes për të marrë masat e duhura për të adresuar sfidat që rrjedhin prej saj.

Tabela 4. Përkatësia fetare e popullsisë në 2011

	Islam	Ortodoks	Katolik	Të tjerë	Pa religjion	Preferon të mos përgjigjet	Nuk janë në dispozicion
Meshkuj	28,701	268	285	4	3	38	21
Femra	27,683	252	287	3	3	30	27
Gjithsej	56,384	520	572	7	6	68	48

Burimi: ASK, 2011


Ndonëse të dhënat specifike për regjistrimin e popullsisë ende nuk janë përfundimtare, statistikën rreth përkatësisë fetare sipas vlerësimeve nuk duket të kenë ndryshuar krahasuar me vitin 2011.

6.4. Shtrirja gjeografike

Lipjani ka një pozicion të përshtatshëm gjeografik në pjesën qendrore të Republikës së Kosovës, duke qenë në udhëkryqin e rrugëve më të rëndësishme të rajonit. Komuna ka gjithsej 62 vendbanime, me shumicën e tyre të koncentruar në rrafshin e Kosovës, ndërsa të tjerat shtrihen në pjesët lindore dhe perëndimore të kufijve morfologjikë.

Komuna kufizohet me Ferizaj, Fushë Kosovë, Graçanicë, Prishtinë, Drenas, Suharekë, Malishevë, Shtime, Gjiilan dhe Artanë. Territori i komunës mbulon një sipërfaqe prej 338.54 km², dhe densiteti i popullsisë është 162.4 banorë/km.⁸ Lipjani është një qendër e rëndësishme për qarkullimin rrugor dhe hekurudhor, dhe për atë ajror. Qyteti i është i pozicionuar në udhëkryqin midis dy rrugëve/autostradave të rëndësishme 25/E 75 dhe 2/E 65, dhe të hekurudhës kryesore Mitrovicë-Shkup, si dhe duke qenë afër Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës Adem Jashari, ofron një infrastrukturë të mirë dhe një pozitë të favorshme për zhvillim. Sipërfaqja e komunës përfshin një diversitet të madh të peizazheve, duke përfshirë zona urbane, rurale dhe natyrore, që krijojnë kushte të favorshme për bujqësi, industri dhe turizëm.

Figura 1. Territori i Komunës së Lipjanit



Burimi: Komuna e Lipjanit, 2024

Lipjani ka qasje të shkëlqyer në trafikun rrugor dhe hekurudhor, dhe përmes Vrellës, edhe në transportin ajror, me Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës/Adem Jashari që ndodhet vetëm 15 km larg nga qendra e Komunës.

Rezervati Blinaja në perëndim ofron mundësi për zhvillim si qendër rekreative, ndërsa Shpella e Mermerit në Gadime është një atraksion turistik i njohur. Parku kulturo-historik në Kleçkë dhe Divjakë, si dhe qyteza e vjetër e Janjevës, tërheqin gjithashtu vizitorë. Pozita strategjike e Lipjanit favorizon zhvillimin ekonomik të

⁸ Komuna e Lipjanit, 2024. https://kk.rks-gov.net/lipjan/?page_id=200000109


komunës. Hekurudha që kalon përmes territorit të saj e lidh Lipjanin me të gjitha drejtimet në rajon.

6.5. Administrimi i Komunës

Në komunën e Lipjanit, strukturat administrative janë të organizuara në disa drejtori kryesore, secila me përgjegjësi specifike që kontribuojnë në funksionimin e përgjithshëm të komunitetit.

Nën udhëheqjen e Kuvendit të Komunës dhe Kryetarit të Komunës, të cilat kanë përgjegjësi të ndara legjislative dhe ekzekutive, Komuna ka ndërtuar një strukturë prej trembëdhjetë (13) drejtorish të përshtatur sipas nevojave dhe kërkesave specifike të saj. Kjo strukturë, siguron një menaxhim të efektshëm dhe efikas të shërbimeve dhe resurseve komunale, duke mundësuar një qeverisje më të mirë dhe një shërbim më cilësor për qytetarët. Përmes organogramit paraqitet struktura në drejtoritë e Komunës së Lipjanit

Figura 2. Organogrami i administratës së Komunës së Lipjanit



Drejtorati për Administratë është përgjegjëse për menaxhimin e shërbimeve administrative, përgatitjen dhe mirëmbajtjen e dokumentacionit zyrtar dhe organizimin e proceseve zgjedhore lokale. Ky departament siguron që të gjitha procedurat administrative të jenë transparente dhe të rregullta, duke mbështetur kështu një qeverisje efektive dhe të besueshme.

Në fushën e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, **Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale** menaxhon shërbimet shëndetësore dhe sociale, implementon programe për kujdesin parësor shëndetësor, për mbrojtjen sociale dhe koordinon shërbimet për grupet e ndjeshme të popullsisë. Kjo drejtori siguron që qytetarët të kenë qasje në shërbime shëndetësore cilësore dhe mbështetje sociale, duke përmirësuar kështu cilësinë e jetës së tyre.

Në sektorin e arsimit, **Drejtorati për Arsim** administron institucionet arsimore dhe zbaton politikat arsimore lokale dhe kombëtare. Ajo mbështet zhvillimin profesional të mësimitdhënësve dhe siguron që të rinjtë e Lipjanit të marrin një arsim cilësor dhe të barabartë, duke kontribuar në ndërtimin e një të ardhme të suksesshme për komunitetin.

Në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, **Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport** organizon dhe mbështet aktivitete kulturore dhe sportive, promovon pjesëmarrjen e rinisë në aktivitete shoqërore dhe menaxhon objektet kulturore dhe sportive. Kjo drejtori ndihmon në ndërtimin e një komuniteti të gjallë dhe aktiv, duke ofruar mundësi për zhvillim personal dhe social për të rinjtë dhe të gjithë qytetarët.

Drejtorati për Buxhet dhe Financa ka një rol kyç në hartimin dhe zbatimin e buxhetit komunal, menaxhimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, dhe mbikëqyrjen e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm. Kjo drejtori siguron që fondet publike të përdoren në mënyrë të përgjegjshme dhe efikase, duke garantuar qëndrueshmërinë financiare të komunës.

Në fushën e zhvillimit ekonomik dhe planifikimit hapësinor, **Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim** mbështet rritjen ekonomike lokale dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Ajo punon në promovimin e investimeve dhe krijimin e mundësive për zhvillim të biznesit, duke kontribuar në përmirësimin e standardit të jetesës për qytetarët.

Drejtoria për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit është përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e hapësirës urbane, si dhe dhënien e lejeve ndërtimore. Me planifikimin hapësinor sigurohet që zhvillimi i komunës të jetë i qëndrueshëm dhe në përputhje me standardet mjedisore dhe rregullat urbane.

Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastrë menaxhon regjistrimin e pronave dhe hartimin e hartave kadastrale. Ajo siguron që të gjitha pronat të jenë të regjistruara saktësisht dhe në përputhje me ligjet e pronësisë, duke ndihmuar në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të pronësisë dhe përmirësimin e menaxhimit të tokës.

Drejtoria për Infrastrukturë menaxhon projektet komunale dhe zhvillon programet e investimeve në infrastrukturë si dhe cakton kriteret e ndërtimit të infrastrukturës, menaxhon kontratat e investimeve publike të infrastrukturës së komunës, duke përfshirë rrugët, urat, kanalizimet, sistemin e ujësjellësit, ndriçimin publik. Ajo siguron që infrastruktura të jetë e qëndrueshme dhe të përmbushë nevojat e komunitetit, duke përmirësuar cilësinë e jetës për të gjithë banorët.

Drejtoria për Inspeksion ka përgjegjësi për inspektimin e zbatimit të ligjeve dhe rregulloreve komunale, mbikëqyrjen e shërbimeve publike dhe sigurisë së produkteve, dhe përgatitjen e raporteve inspektuese. Ajo siguron që të gjitha aktivitetet në komunë të jenë në përputhje me standardet ligjore dhe rregulloret lokale, duke mbrojtur kështu interesat e qytetarëve.

Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari është përgjegjëse për mbështetjen e zhvillimit të bujqësisë dhe aktiviteteve rurale. Ajo implementon programe për mbështetjen e fermerëve dhe promovon zhvillimin e qëndrueshëm rural, duke luajtur një rol kyç në rritjen e ekonomisë lokale dhe përmirësimin e kushteve të jetesës në zonat rurale.

Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim siguron mirëmbajtjen e infrastrukturës, organizon dhe koordinon shërbimet e emergjencës, zhvillon plane të mbrojtjes civile dhe menaxhimit të krizave, dhe trajnon dhe pajis ekipet e shpëtimit. Kjo drejtori është thelbësore për sigurinë dhe mirëqenien e qytetarëve, duke siguruar një reagim të shpejtë dhe efektiv në rast të emergjencave dhe krizave.

Drejtoria për Prokurim menaxhon proceset e prokurimit për komunën, duke siguruar që të gjitha blerjet publike të jenë transparente dhe të bëra në përputhje me

ligjet dhe rregulloret e prokurimit publik. Kjo drejtori ndihmon në maksimizimin e efikasitetit dhe efektivitetit të shpenzimeve publike.

6.6. Ekonomia dhe punësimi

Në nivel vendi, përgjatë vitit 2023, ekonomia ka shënuar një rritje të Bruto Prodhimit Vendor (BPV) prej 3.3%. Në fund të vitit 2022, paga mesatare ishte 521 euro. Papunësia qëndroi në rreth 10.7%, ndërsa inflacioni, pavarësisht rritjes së viteve të fundit, u ul në 2.4%. (ASK, 2023). Pritjet për trendet ekonomike në nivel vendi për vitet e ardhshme janë pozitive ndonëse disbalance të caktuara mbeten aktuale sa i përket raporteve të importit dhe eksportit, të hyrave që gjenerohen brenda karshi të hyrave të jashtme si dhe papunësisë dhe tregut të pa strukturuar mirë, me dominim të tregtisë si sektori primar.

Këto sfida reflektohen edhe në zhvillimin ekonomik lokal për të cilat kërkohet angazhim i përbashkët dhe përkushtim i vazhdueshëm në adresimin e tyre. Ekonomia dhe punësimi vazhdojnë të mbeten sfera të interesimit të shtuar të institucionit të Komunës dhe të qytetarëve të Lipjanit. Pjesa në vazhdim paraqet një pasqyrë të detajuar të gjendjes së punësimit dhe ekonomisë në Komunën e Lipjanit. Ajo përfshin të dhëna mbi tregun e punës, sektorët kryesorë ekonomikë, bizneset dhe sfidat kryesore për zhvillim ekonomik dhe punësim të qëndrueshëm.

6.6.1. Gjendja e punësimit

Të dhënat mbi punësimin gjatë periudhës 2021-2023 tregojnë një trend pozitiv të rritjes së përgjithshme të fuqisë punëtore në sektorë të ndryshëm. Sipas të dhënave të paraqitura në tabelën 8, totali i të punësuarve është rritur nga 4,463 sa ishte në vitin 2021 në 5,523 në vitin 2023, që paraqet një rritje prej 23.8%. Kjo sugjeron një zgjerim të ndjeshëm të tregut të punës dhe përmirësim të mundësive të punësimit, duke reflektuar zhvillim ekonomik të përgjithshëm. Ky trend është veçanërisht i dukshëm në sektorët e tregtisë, industrisë përpunuese, ndërtimtarisë dhe shërbimeve.

Tabela 5. Numri i të punësuarve në sektorin privat për tri vitet e kaluara

Sektori	2021	2022	2023
Administrimi publik dhe mbrojtja; Sigurimi social	3	3	3
Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	435	485	531
Aktivitetet e patundshmërisë	4	3	5

Aktivitetet e shëndetit të njeriut dhe të punës sociale	99	158	202
Aktivitetet e tjera shërbyese	124	136	205
Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	8	16	16
Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike	125	175	181
Arsimi	426	453	462
Artet, Argëtimi dhe rekreacioni	12	25	18
Bujqesia;Pylltaria dhe Peshkimi	44	41	50
Furnizimi me ujë; Kanalizimi; Aktivitetet e menaxhimit dhe të trajtimit të mbeturinave	42	58	67
Industria nxjerrëse	56	31	28
Industria përpunuese	705	858	937
Informimi dhe komunikimi	37	52	72
Ndërtimtaria	620	701	746
Person Fizik	123	59	17
Shërbimet administrative dhe mbështetëse	75	99	118
Transporti dhe magazinimi	176	245	262
Tregtia me shumicë dhe pakicë; Riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave	1,349	1,508	1,603
Gjithsej	4,463	5,106	5,523

Burimi: ATK, 2024.

Spektori i tregtisë me shumicë dhe pakicë vazhdon të dominojë tregun e punës, duke përfaqësuar afërsisht 29% të totalit të të punësuarve në vitin 2023. Kjo përqendrim tregon rëndësinë e madhe të tregtisë për ekonominë vendore dhe krijimin e vendeve të punës. Krahës kësaj, industria përpunuese ka përjetuar një rritje të qëndrueshme, duke u rritur me 32.9% në periudhën e analizuar, duke theksuar rëndësinë e prodhimit dhe përpunimit në rritjen e punësimit dhe diversifikimin ekonomik. Në të njëjtën linjë, ndërtimtaria ka pasur një zgjerim të qëndrueshëm, duke rritur punësimin me më shumë se 20%, duke reflektuar rritjen e kërkesës për projekte infrastrukturore dhe ndërtimore.

Spektori i shëndetit dhe punës sociale ka shënuar rritje të konsiderueshme, duke dyfishuar numrin e të punësuarve nga 99 në 2021 në 202 në 2023. Kjo rritje reflekton nevojën për më shumë shërbime shëndetësore dhe sociale, si dhe përpjekjet për përmirësimin e sistemeve të kujdesit social dhe shëndetësor. Po ashtu, sektori i

informimit dhe komunikimit ka përjetuar një rritje të shpejtë, me një dyfishim të vendeve të punës gjatë këtyre viteve, duke treguar rritjen e rëndësisë së teknologjisë dhe komunikimit në zhvillimin ekonomik. Ndër sektorët me rritje të konsiderueshme të numrit të ndërmarrjeve është edhe ndërtimtaria, e cila në vitin 2021 kishte 620 kurse në vitin 2024 746 sosh. Kjo përkundër faktit se regjistrimi i fundit i ekonomive familjare dhe banesave ka rezultuar me 6,618 shtëpi/banesa të pabanuara, apo mbi 35% të totalit të tyre.⁹

Nga ana tjetër, disa sektorë kanë përjetuar tkurje ose stagnim. Industria nxjerrëse ka shënuar një rënie të ndjeshme të vendeve të punës, duke humbur gjysmën e të punësuarve gjatë kësaj periudhe, ndoshta si pasojë e burimeve të kufizuara ose rregullave mjedisore më të rrepta. Po ashtu, numri i personave fizikë që operojnë si subjekte të pavarura është zvogëluar ndjeshëm, duke reflektuar një tendencë të kalimit nga format më individuale të punës drejt strukturave më formale të biznesit. Sektori publik dhe sektori financiar kanë mbetur kryesisht të qëndrueshëm, pa ndonjë rritje të ndjeshme të punësimit. Kjo sugjeron një stabilitet në këto sektorë, ku investimet dhe zgjerimi nuk janë prioritetet kryesore për momentin.

Në përgjithësi, të dhënat tregojnë një ekonomi në zgjerim, ku sektorët e tregtisë, industrisë, ndërtimit dhe shërbimeve sociale po krijojnë më shumë vende pune dhe po kontribuojnë në një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Ndërsa disa sektorë po tkurren, rritja në sektorët kryesorë po balancojnë këto tkurje, duke sugjeruar një zhvendosje të fuqisë punëtore drejt aktiviteteve më të qëndrueshme dhe produktive.


6.6.2. Papunësia dhe sfidat e saj

Te dhënat mbi papunësinë në Kosovë gjatë viteve 2021-2023 tregojnë një ulje të ndjeshme të shkallës së papunësisë si për meshkujt ashtu edhe për femrat, megjithëse diferencat gjinore mbeten të dukshme. Në vitin 2021, femrat përballeshin me një shkallë papunësie prej 23.9%, shumë më e lartë krahasuar me 17.7% për meshkujt, duke e çuar nivelin e përgjithshëm të papunësisë në 19.9%. Në vitin 2022, papunësia pësoi rënie për të dyja gjinitë, me një përmirësim të dukshëm për meshkujt, ku shkalla e papunësisë ra në 8.9%, ndërsa për femrat u ul në 19.4%, duke rezultuar në një shkallë totale papunësie prej 11.8%. Viti 2023 shënoi uljen më të madhe të papunësisë tek meshkujt, që arriti 7.9%, ndërsa papunësia tek femrat mbeti më e lartë, me 17.2%, duke

⁹ ASK, 2024. Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave. <https://askapi.rks-gov.net/Custom/1d268e37-5934-4bd5-bbd1-34a9965cff92.pdf>

sjellë shkallën e përgjithshme të papunësisë në 10.7%. Megjithatë ka një trend të përgjithshëm pozitiv të uljes së papunësisë, të dhënat tregojnë se femrat ende përballen me sfida më të mëdha në tregun e punës, duke sugjeruar nevojën për politika më gjithëpërfshirëse që të adresojnë pabarazitë gjinore.

Figura 3. Papunësia në Kosovë në tri vitet e fundit



Burimi: ASK, 2024

Në mungesë të të dhënave për Komunë e Lipjanit sa i përket numrit të regjistruar të punëkërkueseve dhe për të përcaktuar proporcionalisht përfaqësimin e personave nga Komuna e Lipjanit brenda regjionit të Prishtinës, mund të përdorim disa të dhëna demografike dhe punësimi të komunave brenda regjionit të Prishtinës për të bërë krahasime. Përkundër kësaj zyra e Punësimit në Komunën e Lipjanin ka të evidentuar afërsisht 2700 punëkërkues aktivë.

Tabela 6. Punëkërkues të regjistruar sipas regjioneve¹⁰

	2014	2020	2021	2022
Gjakovë	14,956	17,178	7,028	6,372
Gjilan	31,259	15,429	6,300	6,807
Mitrovicë	56,026	29,948	19,497	18,348
Pejë	19,598	16,227	10,053	10,325
Prizren	49,794	30,377	10,180	10,059
Prishtinë	70,452	44,075	20,945	21,588
Ferizaj	32,402	15,746	8,039	7,276
Gjithsej	274,487	168,980	82,042	80,775

Burimi: ASK, 2023

¹⁰ Sipas legjislacionit përkatës, prej vitit 2015 raportohen vetëm personat e papunë që regjistrohen pranë zyrave të punësimit dhe paraqiten çdo tre muaj. Në rast se një person nuk paraqitet dy herë radhazi (brenda një periudhe prej gjashtë muajsh), ai konsiderohet joaktiv dhe largohet nga regjistri i të papunëve.

Për të përcaktuar proporcionalisht përfaqësimin e personave nga Komuna e Lipjanit brenda regjionit të Prishtinës, mund të përdorim disa të dhëna demografike dhe punësimi të komunave brenda regjionit të Prishtinës për të bërë krahasime.

Duke marrë parasysh se Prishtina përbën një pjesë të madhe të regjionit me 21,588 persona në vitin 2022 dhe Lipjani është një nga komunat që bën pjesë në këtë regjion, numri i personave nga Lipjani do të përcaktohej si një përqindje e popullsisë dhe pjesëmarrjes ekonomike në krahasim me numrin e përgjithshëm të raportuar për Prishtinën.

Nëse Lipjani ka, përafërsisht, rreth 10% të popullsisë së regjionit të Prishtinës, atëherë proporcionalisht mund të pritet që edhe rreth 10% e të papunëve të regjistruar ose të punësuarve të jenë nga Lipjani. Kjo do të përbënte rreth 2,159 persona (10% e 21,588) nga Lipjani në vitin 2022, bazuar në këtë llogaritje proporcionale. Megjithatë, mbetet e vështirë të përcaktohet numri i saktë i personave të papunë duke marrë për bazë këtë shifër, nivelin e punësimit, popullsinë e përgjithshme aktive dhe shumë faktorë tjerë. Ajo që mund të konkludohet me siguri të lartë nga shumë burime, është fakti se papunësia, sidomos të rinjtë dhe femrat mbetet problem i mprehtë edhe për Komunën e Lipjanit.

Në anën tjetër, të dhënat e periudhës 2021-2023 tregojnë një turrje të konsiderueshme të popullsisë ekonomike jo aktive në vend, çka tregon për përmirësim të pjesëmarrjes në tregun e punës.

Tabela 7. Popullsia ekonomike jo aktive

	2021			2022			2023		
	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Popullsia ekonomike jo aktive (në mijëra)	266,013	482,217	748,230	264,056	469,476	733,532	243,270	451,143	694,413
Shkalla e popullsisë ekonomike jo aktive si pjesë e popullsisë në moshë pune	43.4	78.0	60.7	44.5	78.0	61.4	-	-	-

Burimi: ASK, 2024

Në vitin 2021, numri total i popullsisë jo aktive ishte 748,230 mijë persona, por ky numër ra në 733,532 mijë persona në vitin 2022, duke shënuar një turrje prej 1.96%. Ky trend vijoi edhe në vitin 2023, ku popullsia jo aktive u ul në 694,413 mijë persona, një rënie prej 5.33% krahasuar me vitin e mëparshëm. Ky reduktim i numrit të

personave jo aktivë sugjeron përmirësim të kushteve ekonomike dhe ndoshta rritje të punësimit ose migrimin e tyre drejt tregjeve të punës jashtë vendit.

Në ndarjen sipas gjinisë, meshkujt përbënin 266,013 mijë persona të popullsisë jo aktive në vitin 2021, ndërsa ky numër ra në 243,270 mijë në vitin 2023, një ulje prej 8.56%. Nga ana tjetër, femrat gjithashtu përjetuan një rënie të popullsisë jo aktive, nga 482,217 mijë në 2021 në 451,143 mijë në 2023, duke përfaqësuar një tkurje prej 6.45%. Pavarësisht kësaj, femrat mbeten grupi më i madh i popullsisë jo aktive ekonomikisht, çka tregon për një hendek të vazhdueshëm gjinor në pjesëmarrjen në tregun e punës dhe mundësitë për punësim.

Shkalla e popullsisë ekonomikisht jo aktive si pjesë e popullsisë në moshë pune ishte 60.7% në vitin 2021 dhe u rrit pak në 61.4% në vitin 2022, duke sugjeruar një qëndrueshmëri në përqindjen e popullsisë jo aktive. Edhe pse të dhënat për vitin 2023 nuk janë të plota në lidhje me shkallën e pjesëmarrjes, me rënien e numrit të përgjithshëm të popullsisë jo aktive, mund të pritet një ulje e lehtë e kësaj përqindjeje.

Në përgjithësi, të dhënat reflektojnë përmirësim të qëndrueshëm në drejtim të reduktimit të popullsisë jo aktive ekonomikisht, ndërkohë që femrat vazhdojnë të mbeten më të prekura nga kjo situatë. Kjo kërkon një fokus më të madh në përfshirjen e tyre në tregun e punës dhe krijimin e politikave që mbështesin barazinë gjinore në mundësitë për punësim dhe zhvillim ekonomik.

Tabela në vijim paraqet të dhënat për të rinjtë që nuk janë të punësuar, nuk ndjekin shkollimin ose trajnime (NEET) për periudhën 2021-2023, të ndara sipas gjinisë dhe totalit.

Tabela 8. Të rinj që nuk janë të punësuar, nuk ndjekin shkollimin ose trajnime (NEET)

	2021			2022			2023		
	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Të rinj NEET (në mijëra)	53,851	51,281	105,132	49,665	49,040	98,705	48,369	47,824	96,193
Pjesëmarrja e të rinjve NEET në popullsinë e re (%)	31,8	32,4	32,1	32,2	33,8	33,0	32,9	33,9	33,4

Burimi: ASK, 2024

Të dhënat pasqyrojnë një ulje të numrit të përgjithshëm të të rinjve NEET gjatë kësaj periudhe, por gjithashtu tregojnë një prirje të vazhdueshme të pjesëmarrjes së lartë të femrave në këtë kategori.

Në vitin 2021, numri total i të rinjve NEET ishte 105,132 mijë persona, i ndarë afërsisht në mënyrë të barabartë midis meshkujve dhe femrave. Ky numër ka rënë gradualisht në vitet e ardhshme, duke arritur në 98,705 mijë në vitin 2022 dhe më tej në 96,193 mijë në vitin 2023. Kjo tregon një ulje të përgjithshme prej 8.5% në periudhën trevjeçare. Ulja e numrit të të rinjve NEET sugjeron përmirësime në politikat për arsimin, punësimin dhe trajnimin profesional të kësaj kategorie.

Megjithatë, një vëzhgim më i thellë tregon një trend të pabarabartë në pjesëmarrjen e meshkujve dhe femrave në këtë kategori. Për vitin 2021, pjesëmarrja e të rinjve NEET në popullsinë e re ishte 31.8% për meshkujt dhe 32.4% për femrat. Deri në vitin 2023, pjesëmarrja e femrave në kategorinë NEET kishte arritur në 33.9%, krahasuar me 32.9% për meshkujt. Ky hendek gjinor sugjeron se femrat kanë një shkallë më të lartë të përjashtimit nga arsimi, punësimi dhe trajnimi, duke mbetur një grup më i cenueshëm.

Kjo situatë ngre nevojën për ndërhyrje të politikave që synojnë të përmirësojnë mundësitë për punësim dhe arsimim për femrat e reja. Përkundër përmirësimeve të përgjithshme, pjesëmarrja e lartë e femrave në këtë kategori tregon se shumë prej tyre mbeten të përjashtuara nga tregu i punës dhe zhvillimi arsimor, duke ndikuar negativisht në perspektivat e tyre për të ardhmen.

Ndonëse nuk disponojmë me të dhëna të sakta për Komunën e Lipjanit, Tabela në vazhdim paraqet shkallët e varësisë ekonomike për periudhën 2021-2023 në nivel vendi, duke përfshirë shkallën e varësisë efektive të të moshuarve dhe shkallën totale të varësisë ekonomike. Këto tregues na japin një pasqyrë të ngarkesës ekonomike që grupe të caktuara të popullsisë, si të moshuarit dhe të tjerët ekonomikisht jo aktivë, ushtrojnë mbi popullsinë aktive dhe në moshë pune.

Tabela 9. Shkallët e varësisë ekonomike 2021 - 2023

	2021	2022	2023
Shkalla e varësisë efektive ekonomike e të moshuarve	49	48	47
Shkalla totale e varësisë ekonomike	248	230	-

Burimi: ASK, 2023

Shkalla e varësisë ekonomike të të moshuarit ka pësuar një ulje të vazhdueshme gjatë periudhës 2021-2023. Në vitin 2021, kjo shkallë ishte 49%, që do të thotë se për çdo 100 persona në moshë pune, kishte 49 persona të moshuar që mbështeteshin ekonomikisht. Në vitin 2022, kjo shkallë ra në 48%, ndërsa në vitin 2023 u ul më tej në 47%. Kjo tregon një lehtësim të ngarkesës ekonomike mbi popullsinë në moshë pune për sa i përket mbështetjes së të moshuarve, që mund të reflektojë përmirësime në sistemin e mbrojtjes sociale ose ndryshime demografike si ulja e përqindjes së të moshuarve në popullsi.

Shkalla totale e varësisë ekonomike, që përfshin të moshuarit dhe pjesën tjetër të popullsisë jo aktive, ka pësuar një rënie të ndjeshme në periudhën 2021-2022. Në vitin 2021, kjo shkallë ishte 248%, që tregon një ngarkesë shumë të madhe mbi popullsinë aktive, ku çdo 100 persona në moshë pune mbështetnin 248 persona jo aktivë. Deri në vitin 2022, kjo shkallë ra në 230%, duke treguar një përmirësim të konsiderueshëm të ngarkesës ekonomike. Megjithatë, të dhënat për vitin 2023 nuk janë të plotësuara për shkallën totale të varësisë ekonomike, duke lënë një zbrazëti në analizën për vitin e fundit.

Në përgjithësi, të dhënat tregojnë një përmirësim gradual në ngarkesën ekonomike mbi popullsinë aktive. Shkalla e varësisë efektive të të moshuarve ka rënë çdo vit, duke reflektuar një lehtësim të ngarkesës për mbështetjen e tyre. Po ashtu, shkalla totale e varësisë ekonomike ka pësuar një ulje të konsiderueshme, edhe pse mbetet ende relativisht e lartë, duke sugjeruar nevojën për vazhdimësinë e politikave që përkrahin zhvillimin ekonomik dhe rritjen e pjesëmarrjes në tregun e punës.

6.6.3. Bizneset aktive

Në total, janë 2,740 ndërmarrje aktive në të gjithë sektorët në Komunë e Lipjanit, duke reflektuar një bazë të gjerë ekonomike dhe një diversitet të ndërmarrjeve që kontribuojnë në ekonominë lokale. Ky diversitet sugjeron një ekonomi relativisht të qëndrueshme dhe me potencial për zhvillim në sektorë të ndryshëm.

Tabela 10. Sektorët ekonomik

Sektori	Aktiv	%
Bujqësia Pylltaria dhe Peshkimi	118	4.31%
Xeheroret dhe Gurëthyesit	8	0.29%
Industria Përpunuese, Prodhimtaria	294	10.73%
Furnizimi me Rrymë, Gaz, Avull dhe Klimatizim	7	0.26%
Ujësjetllësi, Kanalizimi, Menaxhimi i Mbeturinave dhe Aktivitetet e Riparimit	18	0.66%
Ndërtimtaria	346	12.63%

Tregtia me Shumicë dhe Pakicë, Riparimi i Mjeteve Motorike dhe Motoçikletave	820	29.91%
Transporti dhe Magazinimi	258	9.41%
Hoteleria dhe Akomodimi	191	6.97%
Informimi dhe Komunikimi	53	1.94%
Aktivitetet Financiare dhe të Sigurimit	12	0.44%
Aktivitetet e Patundshmërisë	15	0.55%
Aktivitetet Profesionale Shkencore dhe Teknike	151	5.51%
Aktivitetet Shërbyese dhe të Përkrahjes	135	4.93%
Administrimi Publik dhe i Mbrojtjes, Sigurimi i Detyruar Social	1	0.04%
Arsimi	27	0.99%
Aktivitetet e Shëndetit Njerëzor dhe të Punës Sociale	65	2.37%
Artet, Argëtimi dhe Rekreacioni	59	2.15%
Aktivitetet tjera Shërbyese	162	5.91%
(blank)		
Total	2,740	100%

Burimi: ARBK 2024.

Tabela e ndërmarrjeve aktive tregon një strukturë të diversifikuar të ekonomisë së Lipjanit, me sektorë të ndryshëm që kontribuojnë në zhvillimin e komunës. Sektori më dominues është **tregtia me shumicë dhe pakicë**, riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave, me 820 ndërmarrje aktive, që përfaqësojnë rreth 29.9% të totalit. Ky sektor pasqyron kërkesën e lartë për mallra dhe shërbime, duke u bërë një nga shtyllat kryesore të ekonomisë lokale. Po ashtu, **ndërtimtaria** është një sektor tjetër me rëndësi të madhe, me 346 ndërmarrje aktive, që përfaqësojnë 12.6% të totalit, duke reflektuar zhvillimet infrastrukturore dhe kërkesën për pasuri të paluajtshme. **Industria përpunuese**, me 294 ndërmarrje aktive, kontribuon me 10.7% të totalit, dhe ka rëndësi për prodhimin dhe përpunimin e lëndëve të para, si dhe krijimin e mundësive për punësim. Sektori i **transportit dhe magazinimit**, me 258 ndërmarrje aktive, përfaqëson 9.4% të totalit dhe është i domosdoshëm për lidhjen e tregjeve dhe zhvillimin e lëvizjes së mallrave. Sektori i **bujqësisë, pylltarisë dhe peshkimit** ka 118 ndërmarrje aktive (4.3% e totalit), që tregon se, ndonëse sektori është i qëndrueshëm dhe thelbësor për zonat rurale, mbetet më pak i zhvilluar krahasuar me sektorët e tjerë. Ndërkohë, sektorët si **shëndeti** dhe **arsimi** janë më të vegjël në numër, me vetëm 65 dhe 27 ndërmarrje aktive përkatësisht, që pasqyron karakterin e tyre të specializuar dhe të rregulluar. Sektori i **shërbimeve** ka gjithashtu një prani të dukshme me 162 ndërmarrje aktive, duke treguar diversifikimin e kërkesës për shërbime profesionale dhe teknike. Në përgjithësi, sektori i **tregtisë, ndërtimtarisë dhe industrisë përpunuese** dominon strukturën e bizneseve aktive në Lipjan, duke pasqyruar një ekonomi të orientuar drejt aktiviteteve që mbështesin konsumin dhe zhvillimin e

infrastrukturës. Të dhënat sygjerojnë se janë edhe 2,788 biznese të regjistruara në komunën e Lipjanit por që janë pasive përderisa mbi 600 biznese evidentohen si të shuara deri në fund të shtatorit 2024.

6.6.4. Zonat ekonomike

Korridoret ekonomike Lipjan-Babush, Lipjan-Banullë, Lipjan-Shtime, Lipjan-Konjuh si dhe zona ekonomike në Qylagë/Kërqevë, së bashku me korridorin ekonomik në drejtim të Aeroportit, përbëjnë potencial solid për tërheqjen e investimeve dhe për nxitje të zhvillimit ekonomik në komunë.

Zona Ekonomike në Qylagë e quajtur ndryshe sipas terminologjisë në bazë të Ligjit për zonat ekonomike si "Parku Industrial Qylagë", është themeluar me vendim të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë në vitin 2016, në një sipërfaqe prej mbi 56 hektarë me destinim prodhimin, përpunimin dhe shërbimet. Komuna së bashku me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë vazhdon me investimet e nevojshme në infrastrukturë dhe qasje për bizneset në rrugë, energji elektrike dhe ujësjellës e kanalizim. Komuna ka shpallur thirrjen për investitorë qysh në vitin 2022 poashtu është vazhduar me thirrjen e dytë publike edhe përgjatë vitit 2023 dhe është në pritje të rezultateve të para investive.

Përveç zonës së licencuar ekonomike të Qylagës, zona komerciale në Konjuh gjithashtu paraqet një potencial të madh për ushtrimin e veprimtarive të ndryshme afariste, së bashku me atë në Babush dhe Banullë. Këto hapësira viteve të fundit janë zhvilluar dukshëm sidomos me vendosjen e përfaqësive të kompanive të mëdha.

Për të mbështetur dhe nxitur zhvillimin e ekonomik dhe tërheqjen e investimeve, Komuna ka identifikuar hapësirat dhe pronat komunale në të gjitha zonat kadastrale, të cilat do të ofrohen për shfrytëzim nga investitorët privat.¹¹ Për këtë qëllim Komuna ka shpallur disa thirrje në vitet e fundit për dhënen në shfrytëzim të këtyre pronave.¹²

6.7. Arsimi

Sistemi arsimor në Komunën e Lipjanit është i organizuar në katër nivele: niveli parashkollor (niveli 0), arsimi fillor (niveli 1), arsimi i mesëm i ulët (niveli 2), dhe arsimi i mesëm i lartë (niveli 3). Komuna e Lipjanit ka gjithsej 28 institucione arsimore. Këto përfshijnë:

- 1 Institucion për edukimin parashkollor, që siguron kujdes dhe zhvillim për fëmijët para fillimit të arsimit të detyrueshëm.

¹¹ <https://kk.rks-gov.net/lipjan/wp-content/uploads/sites/20/2024/05/Lisa-e-pergjithshme-e-pronave-te-palujtshme-komunale-sipas-zonave-kadastrale-ne-Komunen-e-Lipjanit-1.pdf>

¹² https://kk.rks-gov.net/lipjan/?page_id=200009337

- 24 Shkolla Filllore dhe të Mesme të Ulëta (SHFMU), të cilat ofrojnë arsimim bazë nga klasa e parë deri në klasën e nëntë.
- 3 Shkolla të Mesme të Larta (SHML), të cilat përbëhen nga:
 - 1 Gjimnaz, që ofron një program të gjerë akademik për përgatitjen e nxënësve për studime universitare.
 - 1 Shkollë Profesionale, e cila ofron trajnime dhe arsim profesional në fusha të ndryshme për përgatitjen e nxënësve për tregun e punës.
 - 1 Shkollë Mikse, që kombinon elemente të arsimit të përgjithshëm dhe të arsimit profesional, duke u ofruar nxënësve mundësi të ndryshme për zhvillimin e tyre akademik dhe profesional.¹³

Ky sistem i strukturuar i arsimit në Lipjan synon të sigurojë një bazë të fortë edukative për të gjithë nxënësit, duke mbështetur zhvillimin e tyre intelektual, social dhe profesional.

Të dhënat e ofruara japin një panoramë të gjendjes së arsimit në Komunën e Lipjanit në krahasim me nivelin kombëtar në Kosovë për vitin shkollor 2022-2023. Në nivel parashkollor, Lipjani ka një numër të vogël fëmijësh krahasuar me nivelin kombëtar, me vetëm 294 fëmijë nga gjithsej 5420 në Kosovë, duke pasur një raport meshkuj-femra prej 1.16:1, që është i ngjashëm me raportin kombëtar prej 1.08:1. Në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët, Lipjani ka 9031 nxënës nga gjithsej 212967 në Kosovë, me një raport meshkuj-femra prej 1.1:1, që është i ngjashëm me raportin kombëtar prej 1.06:1. Në arsimin e mesëm të lartë, Lipjani ka 22446 nxënës nga gjithsej 63029 në Kosovë, me një raport meshkuj-femra prej 1.08:1, krahasuar me raportin kombëtar prej 1.02:1, duke treguar një përfaqësim të barabartë gjinor.

Në përgjithësi, numri total i nxënësve në Lipjan është 11571 nga 300362 në Kosovë, me një raport meshkuj-femra prej 1.09:1, të ngjashëm me raportin kombëtar prej 1.05:1. Në aspektin e mësimdhënësve, Lipjani ka një numër relativisht të vogël mësimdhënësish krahasuar me totalin në Kosovë. Në nivel parashkollor, nuk ka mësimdhënës meshkuj në Lipjan, ndërsa në Kosovë dominimi i mësimdhënësve femra është i dukshëm. Në nivelet parafilllore, fillore dhe të mesme të ulëta, ekziston një balancë më e mirë mes meshkujve dhe femrave, por femrat prapë mbizotërojnë. Në arsimin e mesëm të lartë, numri i mësimdhënësve është 162 në Lipjan nga gjithsej 5145 në Kosovë. Në përgjithësi, raporti meshkuj-femra është relativisht i balancuar në të gjitha nivelet e arsimit, duke treguar një përfaqësim të barabartë gjinor në mesin e nxënësve dhe mësimdhënësve. Kjo analizë ndihmon për të kuptuar strukturën e

¹³ Komuna e Lipjanit, raporti vjetor i Kryetarit për vitin 2023

arsimit në Komunën e Lipjanit dhe për të identifikuar mundësitë për përmirësim dhe zhvillim të mëtejshëm.

Le të analizojmë këto të dhëna sipas kategorive të ndryshme.

Tabela 11. Numri i Fëmijëve në Arsimin Parashkollor (2022-2023)

	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Lipjan	160	134	294
Kosovë	2814	2606	5420

Në nivel parashkollor, Lipjani ka një numër të vogël fëmijësh krahasuar me nivelin kombëtar. Nga 5420 fëmijë në gjithë Kosovën, vetëm 294 janë nga Lipjani. Raporti meshkuj-femra në Lipjan është 1.16:1, ndërsa në nivel kombëtar është afërsisht 1.08:1, që tregon një balancë të ngjashme gjinore në të dy nivelet.

Tabela 12. Numri i Nxënësve në Arsimin Fillor dhe të Mesëm të Ulët (2022-2023)

	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Lipjan	4711	4320	9031
Kosovë	109462	103505	212967

Në këtë nivel, Lipjani ka 9031 nxënës nga gjithsej 212967 në Kosovë. Kjo përfaqëson një pjesë të vogël të popullsisë shkollore kombëtare. Raporti meshkuj-femra në Lipjan është 1.1:1, i cili është i ngjashëm me raportin kombëtar prej 1.06:1.

Tabela 13. Nxënësit në Arsimin e Mesëm të Lartë (2022-2023)

	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Lipjan	1154	1092	2246
Kosovë	31799	31230	63029

Në arsimin e mesëm të lartë, Lipjani ka 2246 nxënës nga gjithsej 63029 në Kosovë. Kjo tregon se pjesëmarrja e Lipjanit në këtë nivel është relativisht e ulët. Raporti meshkuj-femra është 1.08:1 në Lipjan dhe 1.02:1 në Kosovë, që tregon një përfaqësim më të barabartë gjinor në nivel kombëtar.

Tabela 14. Numri i Fëmijëve/Nxënësve Sipas Gjinive në të Gjitha Nivelet e Arsimit Parauniversitar (2022-2023)

	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Lipjan	6025	5546	11571
Kosovë	153796	146566	300362

Numri total i nxënësve në Lipjan është 11618 nga 300362 në Kosovë. Kjo tregon se Lipjani përbën një pjesë të vogël të totalit kombëtar. Raporti meshkuj-femra në Lipjan është 1.09:1, i ngjashëm me raportin kombëtar prej 1.05:1.

Tabela 15. Mësimdhënësit sipas Niveleve dhe Gjinitive – Parashkollor

	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Lipjan	0	44	44
Kosovë	2	647	649

Në Lipjan, numri i mësimdhënësve është relativisht i vogël krahasuar me totalin në Kosovë. Në nivel parashkollor, nuk ka mësimdhënës meshkuj në Lipjan, ndërsa në Kosovë dominimi i mësimdhënësve femra është i dukshëm.

Tabela 16. Mësimdhënësit e nivelit Parafillor/Fillor dhe i Mesëm i Ulët

	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Lipjan	206	432	638
Kosovë	6503	10596	17099

Në nivelet e tjera, ekziston një balancë më e mirë mes meshkujve dhe femrave, por femrat prapë dominojnë.

Tabela 17. Mësimdhënësit në nivelin e Mesëm të Lartë

	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Lipjan	75	87	162
Kosovë	2873	2272	5145

Tabela 18. Mësimdhënësit sipas Gjinitive (Totali)

	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Lipjan	263	563	826
Kosovë	9378	13515	22893

Në përgjithësi raporti meshkuj-femra është relativisht i balancuar në të gjitha nivelet e arsimit, duke treguar një përfaqësim të barabartë gjinor në mesin e nxënësve dhe mësimdhënësve.

6.8. Infrastruktura

Infrastruktura është një komponent kyç për zhvillimin ekonomik dhe social të një komune. Ky raport ofron një analizë të detajuar të gjendjes së infrastrukturës në Komunën e Lipjanit, duke përfshirë rrugët, hekurudhat, energjinë elektrike, telekomunikacionin, kanalizimin, ndriçimin publik, ujësjellësin, planifikimin urban, shërbimet publike dhe menaxhimin e mbeturinave.

6.8.1. Rrugët

Gjatësia e rrugëve të asfaltuara: Në Komunën e Lipjanit, rrugët e asfaltuara përbëjnë një pjesë të rëndësishme të infrastrukturës rrugore. Gjatësia totale e rrugëve të asfaltuara është 510 kilometra. Kjo përfshin rrugët kryesore dhe ato dytësore që lidhin fshatrat dhe qytetet brenda komunës.

Gjatësia e rrugëve sipas llojit:

- Rrugë të asfaltuara: 510 kilometra
- Rrugët me zhavor: 90 km

6.8.2. Rrugët hekurudhore

Rruga hekurudhore që lidh Prishtinën me Hanin e Elezit, e cila është në renovim e sipër dhe e cila kalon përmes Komunës së Lipjanit, ka një rëndësi të veçantë për zhvillimin ekonomik dhe infrastrukturor të rajonit. Kjo lidhje hekurudhore jo vetëm që përmirëson ndërlidhjen mes qendrave kryesore të Kosovës dhe portave tregtare, por gjithashtu lehtëson transportin e mallrave dhe njerëzve, duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të zonës dhe rritjen e mundësive për bizneset lokale.

6.8.3. Furnizimi me energji elektrike

Furnizimi me energji elektrike në Komunën e Lipjanit menaxhohet nga ndërmarrjet publike të nivelit qendror, përfshirë prodhimin, shpërndarjen, si dhe planifikimin e investime. Aktualisht furnizimi me energji elektrike konsiderohet i mirë dhe i sigurtë, duke siguruar energji të vazhdueshme për shumicën e banorëve dhe bizneseve. Megjithatë, ka raste sporadike të ndërprerjeve, të cilat ndikojnë kryesisht zonat rurale.

Komuna e Lipjanit aktualisht nuk disponon një sistem të ngrohjes qendrore për qytetin, duke bërë që banorët të shfrytëzojnë energjinë elektrike, dru ose qymyr për ngrohje gjatë sezonit të dimrit. Ndërtimi i një sistemi të ngrohjes qendrore në qytet do të siguronte ngrohje cilësore dhe më të përballueshme, si dhe për të reduktuar ndotjen e mjedisit. Ky projekt do të përmirësonte ndjeshëm cilësinë e jetës së banorëve dhe do

të kontribuonte në një mjedis më të pastër dhe të qëndrueshëm. Megjithatë, financimi i një projekti të tillë aktualisht mbetet i pamundur deri në gjetjen e ndonjë mbështetje financiare përmes burimeve jashtë komunës si donatorët apo edhe sektori privat përmes ndonjë forme të partneritetit.

Poashtu, Komuna e Lipjanit ka potencial të madh për investime në energjinë e ripërtëritshme, sidomos në atë solare e cila do të shfrytëzohej për familje dhe biznese. Komuna mund të përfitojë investime të konsiderueshme dhe projekte në këtë sferë duke bashkëpunuar me nivelin qendror, donatorët por edhe me sektorin privat. Në këtë kuadër do të synohet angazhimi në zbatimin e agjendës së gjelbër në komunën e Lipjanit përmes projekteve dhe programeve të qëndrueshme duke pasur për bazë gjithpërfshirjen dhe ndikimin sa më të vogël në ndotjen e ambientit.

Aplikimi i parimeve të ekonomisë qarkore si një model ekonomik synon të minimizojë mbetjet dhe të maksimizojë përdorimin e burimeve përmes një cikli të mbyllur të prodhimit dhe konsumit. Në vend të qasjes tradicionale lineare "merr, përdor, dhe hidh", ekonomia qarkore do të fokusohet në ripërdorimin, riparimin, rinovimin dhe riciklimin e materialeve dhe produkteve. Ky model jo vetëm që do të kontribuon në mbrojtjen e mjedisit dhe reduktimin e ndikimit negativ të prodhimit industrial, por gjithashtu do të krijojë mundësi për inovacion, zhvillim të qëndrueshëm dhe rritje të punësimit në sektorë të rinj ekonomikë.

6.8.4. Telekomunikacioni

Shtrirja e telekomunikacionit në komunë është poashtu e mirë, me mbulim të gjerë të rrjetit të telefonisë mobile, internetit dhe fibrës optike. E gjithë zona e komunës dhe shumica e banorëve kanë qasje në shërbime të shpejta të internetit dhe komunikimit, duke përmirësuar ndjeshëm cilësinë e jetës dhe ofruar mundësi të reja si puna nga distanca, edukimi online dhe shërbimet publike digjitale. Kjo infrastrukturë poashtu ka ndihmuar bizneset lokale të rrisin efikasitetin dhe të zgjerojnë tregjet e tyre, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe social të komunës.

6.8.5. Kanalizimi dhe ndriçimi publik

Gjatësia e kanalizimit fekal dhe atmosferik:

- Kanalizimi fekal: 275 kilometra
- Kanalizimi atmosferik: 230 kilometra

Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit mbetet një nevojë kritike dhe Komuna ka planifikuar investime të vazhdueshme dhe të qëndrueshme në këtë sektor për vitet e ardhshme. Këto investime do të synojnë të rrisin mbulueshmërinë dhe cilësinë e shërbimeve të kanalizimit në tërë territorin e Komunës, duke përmirësuar infrastrukturën dhe jetesën e qytetarëve.

Gjatësia e trotuareve dhe ndriçimi publik

- Trotuare: 155.78 kilometra
- Ndriçimi publik: 225.5 kilometra

Investimi në trotuare dhe pjesë të ndriqeshme të rrugëve mbetet përkushtim i vazhdueshëm i Komunës.

6.8.6. Ujësjiellësi dhe furnizimi me ujë

Gjatësia e ujësjiellësit: Ujësjiellësi në Komunën e Lipjanit ka një shtrirje të gjerë, duke siguruar furnizim të vazhdueshëm dhe cilësor me ujë për shumicën e banorëve. Furnizimi me ujë është i mirë por nevojiten investime të vazhdueshme për të siguruar mbulueshmërinë e nevojshme me furnizim.

6.8.7. Planifikimi urban dhe hapësirat publike

Planifikimi urban: Komuna e Lipjanit ka një planifikim urban të mirë, me destinim të zonave të banimit, zonave afariste, bujqësore, rekreative etj.

Planifikimi Urban është i rregulluar me Hartën Zonale të Komunës 2021 – 2029, e cila përcakton në detaje llojin, qëllimin dhe përdorimin e planifikuar të hapësirës, si dhe masat e veprimit të bazuara në projeksione të realizueshme të investimeve publike dhe private për tërë territorin e Komunës.

Draft Plani Zhvillimor Komunal 2023-2031(PZHK) për Lipjanin synon një zhvillim policentrik, duke mbështetur zhvillimin në pesë nën-qendra (Janjevë, Slllovi, Shalë, Gadime, dhe Magure) dhe në qendrën kryesore, qytetin e Lipjanit. Ky koncept e ndan komunën në katër zona kryesore: (1) Qyteti me nën-qendrat; (2) Pyjet; (3) Tokat bujqësore; dhe (4) Aeroporti. Gjithashtu, PZHK ka përcaktuar zona të veçanta për zhvillim dhe mbrojtje, si Gadimen, Janjeven, Kleçkën, Divjakën dhe Blinajen.

Zhvillimi policentrik synon të mbrojë dhe të zhvillojë tokat bujqësore si pasuri natyrore e komunës, duke kontrolluar dhe balancuar zhvillimin, dhe duke promovuar një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, social dhe mjedisor. Fokusi kryesor i komunës

do të jetë zhvillimi ekonomik dhe përmirësimi i infrastrukturës. Megjithatë, pjesa më e madhe e tokës në komunën e Lipjanit do të mbetet e dedikuar dhe e mbrojtur për bujqësi dhe pylltari. Pjesët e tjera të tokës do të shfrytëzohen për qëllime të banimit, industrisë, biznesit, transportit (rrugor dhe ajror, përfshirë aeroportin e Prishtinës), turizmit dhe sektorëve të tjerë të nevojshëm.

6.8.8. Transporti publik dhe parkingjet publike

Transporti publik: Aktualisht, Komuna e Lipjanit nuk posedon transport lokal publik, por shërbimi i transportit ofrohet nga operatorët privat të licencuar. Nga transporti rrugor i udhëtarëve me autobus në territorin e komunës janë të përfshira 57 fshatra (91.94%) me 174 (89.69%)¹⁴ vendndalje të shënjëzuara për marrje dhe zbritje të udhëtarëve ku gjithsej operojnë 12 operatorë. Ndërsa numri i operatorëve auto taksi të licencuar nga komuna është afërsisht 200, prej të cilave 100 prej tyre operojnë në Aeroportin Ndërkombëtarë "Adem Jashari".

Parkingjet publike: Komuna ofron parkingje publike të mjaftueshme në zonat kryesore, megjithëse mund të ketë mungesa në kohë të pikut. Parkingjet gjithsej në kuadër të territorit të komunës janë 125 me kapacitet prej rreth 3,370 vendparkingje ku përfshihen hapësira publike, shirita rrugor dhe parkingje të bizneseve.

6.8.9. Menaxhimi i mbeturinave dhe shërbimet publike

Menaxhimi i mbeturinave: Menaxhimi i mbeturinave bëhet nga Kompania Rajonale Pastrimi me njësinë e saj në Komunën e Lipjanit. Ky sektor ka shënuar përparime por ende mbetet punë për të siguruar standard të duhur në grumbullimin, bartjen dhe posaçërisht në riciklimin e mbeturinave.

Shërbimet publike: shërbimet publike në Komunën e Lipjanit përfshijnë mirëmbajtjen e infrastrukturës, ndriçimin publik, furnizimin me ujë dhe kanalizimin, mirëmbajtjen e rrugëve dhe trotuareve gjatë sezones verore dhe dimërore, hapësirave të gjelbërta, parkingjeve publike, funksionimin e tregjeve etj.

Përgjithësisht, gjendja e infrastrukturës në Komunën e Lipjanit është relativisht e mirë, me disa fusha që kërkojnë përmirësime. Rrugët, furnizimi me energji elektrike, telekomunikacioni dhe menaxhimi i mbeturinave janë të zhvilluara, duke siguruar

¹⁴ MAPL, Raporti përfundimtar i performancës për Komunën e Lipjanit, 2023. <https://mapl.rks-gov.net/wp-content/uploads/2024/07/Komuna-Lipjan.pdf>

shërbime të nevojshme për banorët. Megjithatë, përmirësimet në transportin publik dhe planifikimin urban do të kontribuojnë në rritjen e cilësisë së jetës dhe zhvillimit të qëndrueshëm të komunës.

6.9. Shëndetësia

Komuna e Lipjanit ka gjithsej 12 institucione/objekte shëndetësore, duke përfshirë:

- Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF): 1 QKMF,
- Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF): 4 QMF,
- Ambulanca të Mjekësisë Familjare (AMF): 7 AMF.

Gjendja e këtyre institucioneve shëndetësore është shumë e mirë, me përjashtim të dy Ambulancave të Mjekësisë Familjare asaj në Banullë dhe në Smallushë, të cilat nuk janë aktive për shkak të numrit të vogël të pacientëve. Në institucione shëndetësore nuk ka nevojë për investime të mëdha shtesë, me përjashtim të dy AMF-ve të lartcekura.

Qendrat e Mjekësisë Familjare QMF-të janë komplet të renovuara dhe ofrojnë kushte të avancuara për ofrim të shërbimeve të kujdesit parësor shëndetësor. QMF në Gadime dhe QMF në Janjevë janë model jo vetëm në nivel vendi por edhe në regjion. Qendra e Re Urgjente si pjese përbërëse e QKMF-së në Lipjan është duke u ndërtuar dhe pritet të lëshohet në funksion në vitin e ardhshëm. Poashtu, gjendja me pajisje dhe aparatura shëndetësore është shumë e mirë dhe nuk kërkon investime të mëdha.

QKMF dhe të gjitha QMF-të janë të pajisura me pajisje të avancuara mjekësore si psh: QKMF është e pajisur me aparat të ri digjital të rëntgenit, karrige të reja stomatologjike, tavolinë gjinekologjike dhe pajisje përcjellëse, auto vetura të për bartjen e pacientëve në nevojë, tri autoambulanca të mirëmbajtura mirë, ekg, aparate biokimike dhe hematologjike, autoclav, etj.

Të katër QMF-të, janë të pajisura me aparaturat e nevojshme mjekësore, siç kërkohet me ligj dhe UA për ofrim të shërbimeve shëndetësore në KPSh. Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare me njësitë e sajë është institucion i kujdesit parësor i cili ofron shërbime të kujdesit parësor shëndetësor për banorët e komunës së Lipjanit njëzet e katër orë, shtatë ditë në javë. Kujdesi parësor shëndetësor bazohet në ofrimin e shërbimeve shëndetësore mbi konceptin e Mjekësisë Familjare dhe përfshinë:

1. Promovimin dhe edukimin shëndetësor, parandalimin, zbulimin e hershëm, diagnostikimin, mjekimin dhe rehabilitimin, që kanë të bëjnë me sëmundjet, çrregullimet dhe lëndimet, përfshirë edhe ndërhyrjet e vogla kirurgjike;
2. Vizitat sistematike të nxënësve të shkollave fillore;
3. Imunizimin në pajtim me ligjin;
4. Promovimin e shëndetit oral dhe kujdesit për shëndetin e dhëmbëve;
5. Organizimin e shërbimeve të urgjencës dhe emergjencës mjekësore;
6. Shërbime të kujdesit shëndetësor për nëna dhe fëmijë dhe shërbime të planifikimit familjarë;
7. Kujdes për të moshuarit, kujdes paliativ dhe vizita në shtëpi.

Aktualisht në QKMF janë të punësuar 237 punëtorë, prej tyre 195 të profilit shëndetësor, pjesa tjetër punëtor administrate dhe punëtor të shërbimeve teknike.

Numri i vizitave dhe shërbimeve të ofruara

Gjatë vitit të kaluar, numri i vizitave dhe shërbimeve shëndetësore në objektet shëndetësore në Lipjan ka arritur në 479,452. Kjo përfshin vizitat dhe shërbimet mjekësore. Numri i vizitave dhe shërbimeve të ofruara është rritur për 17,580, në krahasim me vitin paraprak, duke reflektuar një rritje në kërkesën për kujdes shëndetësor.

a. Numri i vizitave

Gjatë vitit të kaluar, numri i vizitave në objektet shëndetësore në Lipjan ka arritur në 240,943.

Tabela 19. Numri i vizitave në objektet shëndetësore

01	Vizita mjekësore në QKMF	112,112
02	Vizita mjekësore në Punte	49,045
03	Vizita emergjente	57,363
04	Vizita stomatologjike	9,620
05	Vizita gjinekologjike	4,676
06	Vizita pediatrike	6,103
07	Vizita pulmologjike	542
08	Vizita paliative	1,482
09	Gjithsej vizita mjekësore	240,943

b. Ofrimi i shërbimeve

Numri i shërbimeve të ofruara gjatë vitit të kaluar, të paraqitura në tabelen në vijim ka qenë 238,509.

Tabela 20. Numri i shërbimeve të ofruara në vitin 2023

01	Gjithsej injeksione	92,552
02	Gjithsej infuzione	38,878
03	Gjithsej lidhje-pastrim plage	18,673
04	Gjithsej Rtg exponime	5,274
05	Gjithsej pacient në laborator	24,082
06	Gjithsej lindje	3
07	Gjithsej EKG	4,976
08	Gjithsej vizita shtëpiake me autoambulancë	759
09	Gjithsej USG	1,294
10	Rrahje	50
11	Gjithsej transport me autoambulancë	1,100
12	Gjithsej Imobilizime	374
13	Gjithsej Oksigjenoterapi	1,229
14	Gjithsej Largim i Penjve	1,183
15	Gjithsej aksident trafiku	304
16	Këshillimorja	12,345
17	Gjithsej vaksina	9,329
18	Teste rapide me antigjen	135
19	Gjithsej vaksina COVID-19	19
20	Referime	22,791
21	Inhalime	644
22	Vizita Infermierike Gjinekologjike	1,022
23	Vizita për nëna dhe fëmijë 0-3 vjeç	759
24	Klasa për nëna në 1000 ditët e para	318
25	Vizita në qendrën e azilit në Magure	60
26	Vizita në qendrën e paraburgimit	83
27	Konstatim vdekje/Mortus ad latta	125
28	Thumbim nga rriqrat	128
29	Dhunë familjare	20
30	Gjithsej shërbime	238,509
31	Përqindja e referimeve	9.55%

Analiza e situatës

Gjendja e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale në Komunën e Lipjanit është e mirë. Komuna e Lipjanit në vitin e kaluar është ranguar në vendin e dytë në nivel vendi për ofrim të shërbimeve shëndetësore në raportin e performancës të nxjerrë nga MAPL dhe partnerët ndërkombëtar të përfshirë në vlerësim.

Qasja në institucionet shëndetësore është avancuar dukshëm duke përfshirë edhe qasjen për personat me Aftësi të kufizuar. Në QKMF dhe në Qendrën për Punë Sociale janë lëshuar në funksion ashensorët, nyjet sanitare të reja për PAK dhe të gjitha institucionet shëndetësore ofrojnë pjerrinat për qasje të lehtë.

Sfidat kryesore:

- Personeli i kualifikuar: Ka një nevojë të madhe për trajnim dhe kualifikim të personelit mjekësor dhe social për të avancuar edhe më tutje cilësinë e shërbimeve të ofruara si përdorimi i ultrazërit nga mjeku familjar dhe implementimi i programeve kujdesi i integruar, vizitat në shtëpi dhe kujdesi ndaj nënës. Komuna e Lipjanit është ndër komunat pe pakta në Kosovë që implementon projektin kujdesi i integruar i cili nënkupton ofrimin e shërbimeve të integruara shëndetësore dhe sociale për pacientët 65+ me Sëmundje Kronike Jo ngjitëse.
 - Implementimi i plotë i projektit të mjekësisë familjare dhe përzgjedhjes së mjekut familjar nga Pacienti.
 - Implementimi i projektit kujdesi për nëna dhe fëmijë deri në moshën tre vjeçare.
 - Implementimi i projektit kujdesi i integruar.
- Funksionalizimi i plotë i komitetit për cilësi më qëllim që të ndikoj në reduktimin e përshkrimit/përdorimit të antibiotikeve në KPSH dhe uljen e referimeve në laborator, imazheri dhe në nivelin terciar.

6.9.1. Mirëqenia sociale

Mbrojtja Sociale si segment i vaqetë i mirëqenies sociale nga këndvështrimi i dimensionit social, përfshinë qasje gjithëpërfshirëse, shumë dimensionale sociale, për garantimin e përfshirjes sociale, përmes ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare, skemave sociale në Komunën e Lipjanit.

Shërbimet sociale për ofrimin e përkujdesjes sociale në kuadër të QPS janë të organizuara përmes dy funksioneve dhe tri shërbimeve:

- Shërbimi Social është shërbim profesional në kuadër të QPS-së, dhe ka rolin e Organit të Kujdestarisë sipas Ligjit për Shërbimet Sociale dhe Familjare.
- Shërbimi për Mirëqenie Sociale është shërbim mbështetës për ofrim të ndihmës së përkohshme financiare (asistencës sociale) për familjet që janë në varfëri.
- Shërbimi Administrativ/Financiar është përgjegjës për menaxhim administrativ dhe financiar të institucionit, QPS-ës.

Shërbimet Sociale dhe të Asistencës Sociale, ofrohen përmes Qendrës për Punë Sociale. QPS si Institucion publik bartë përgjegjësi profesionale në ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare, këshillim dhe ndihmë materiale për qytetarë, në zgjidhjen e problemeve dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarit.

Brenda kompetencës profesionale të QPS, vepron Organi i Kujdestarisë, përgjegjës për mbrojtjen e interesave të fëmijëve dhe të rriturve, i përbërë nga një grup ekspertësh që vepron në fusha të veçanta të përgjegjësisë.

Shërbimet sociale në Komunën e Lipjanit në kuadër të kompetencës profesionale dhe të Organit të kujdestarisë, synojnë:

- Ofrimin e ndihmës ndaj individit, familjes, grupit dhe komunitetit, pavarësisht moshës, aftësisë së kufizuar, problemeve sociale.
- Krijimin e kushteve për zhvillimin dhe fuqizimin e individit dhe familjes për të tejkaluar përjashtimin shoqëror.
- Fuqizimin e familjes dhe parandalimin e ndarjes së fëmijës nga familja e tij, nëpërmjet shërbimeve që mundësojnë ndërtimin dhe ruajtjen e unitetit të familjes, të drejtat, mirëqenien dhe në interesin më të mirë të fëmijës.
- Ofrimin e shërbimeve të mbrojtjes për përfituesin/it, përmes:
 - kujdestarisë;
 - strehimit familjar;
 - strehimit rezidencial;
 - adoptimit;
 - jetesës së pavarur të mbikëqyrur.

Të drejtat e përfituesve në shërbimet e mbrojtjes sociale, realizohen përmes shërbimeve sociale, mbështetjes materiale/financiare, dhe me masa tjera të cilat i ofrohen individit apo familjes.

Shërbimet sociale dhe familjare ofrohen përkohësisht dhe në periudhë të gjatë, prandaj është i rëndësishëm dhe qenësor sistemi i integruar për ofrimin e shërbimeve sociale, shëndetësore dhe arsimore, për një shoqëri të shëndosh dhe pa përjashtim

social, për faktin se Mision i Shërbimeve Sociale në kuadër të veprimtarisë së QPS-së mbetet përmirësimi i jetës së qytetarit dhe promovimi i një shoqëri të mirëqenë ku mbizotëron, qasja e barabartë dhe drejtë sociale, përmes:

- Ofrimit të shërbimeve sociale në aspekt të cilësisë dhe shtrirjes, bazuar në nevojat (grupet e caktuara dhe grup moshat) e komunitetit;
- Mbështetjes së grupeve të cenuara shoqërore, zbutja e varfërisë dhe ofrimi i shërbimeve përkatëse sociale;
- Ndërtimit të partneritetit publiko-privat me institucione dhe OJQ relevante për gjithëpërfshirje sociale, përmes shërbimeve sociale të specializuara dhe përkujdesjes së drejtpërdrejt sociale në komunitet.
- Ofrimi i shërbimeve të mbrojtjes për përfituesin/it përmes formave të mbrojtjes për klientët në nevojë për përkujdesje dhe mbështetje materiale, përfshinë:
- Format alternative të mbrojtjes për fëmijë pa kujdes prindëror dhe mbështetjen material.

Tabela 21. Fëmijet pa përkujdesje familjare nën kujdestari dhe strehim familjar brenda familjes biologjike/2023

Nr.	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
1.	18	19	19	19	19	19	22	22	22	22	22	23
2.	2.700	2.800	2.800	2.800	2.800	2.800	3.300	3.300	3.300	3.300	3.300	3.450

Gjithsej mbështetje materiale për fëmijët pa përkujdesje familjare: 36,650 €

Tabela 22. Fëmijët në strehim familjar jashtë familjes biologjike/2023.

Nr.	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
1.	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1
2.	250.00€	250.00€	250.00€	250.00€	250.00€	250.00€	250.00€	250.00€	250.00€	250.00€	250.00€	250.00€

Gjithsej mbështetja vjetore: 3,000 €

Numri i fëmijë në strehim familjar jashtë familjes biologjike ka variuar në integrim dhe largim sipas nevojës dhe arrijës së moshës madhore brenda vitit, prandaj përfshirja e fëmijëve në strehim familjar gjatë vitit/2023 është njëzet e pesë (25) fëmijë, prej tyre (17) shtatëmbëdhjetë meshkuj, dhe(8) vajza. Strehimi familjar të të afërmit dhe në familje tjetër është realizuar brenda kompetencës territoriale të Lipjanit.

QPS në Lipjan ka dy familje strehuese të miratuara për strehim të fëmijëve jashtë familjes biologjike.¹⁵

Tabela 23. Përkrahja materiale e familjeve me fëmijë me aftësi të kufizuar

Nr.	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
1.	121	121	134	133	133	141	143	141	141	141	149	149
2	12.100	12.100	13.400	13.400	13.400	14.100	14.100	14.100	14.100	14.100	14.900	14.900

Gjithsej mbështetje materiale për familjet e fëmijëve me Aftësi të kufizuar: 164,700.00€

¹⁵ Shënimet nga baza e të dhënave të Komunës së Lipjanit për periudhën 01.01.2023-31.01.2023

Tabela 24. Numri i familjeve dhe anëtarëve të familjes, të cilët kanë përfituar nga skema e ndihmës sociale

Nr.	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
1.	1,208	1,163	1,141	1,113	1,091	1,095	1,085	1,094	1,080	1,047	1,022	1,026
2.	5,179	4,979	4,918	4,782	4,703	4,709	4,695	4,707	4,628	4,524	4,416	4,440

Komuna e Lipjanit ka miratuar strategji dhe mekanizma e plane për grupe të caktuara të shërbimeve sociale, me fokus integrujes të grupeve të caktuara si rrjedhojë e nevojës së qytetarëve dhe reformës ligjore, për avancimin e mirëqenies sociale përmes sigurimit të një sistemi integrujes të ndihmës dhe sigurimit të shërbimeve për intervenim të hershëm tek grupet e cënueshme dhe të marginalizuara në Komunën e Lipjanit.

Synohet target i planeve integruese: Barazia gjinore, integrimi i viktimave të dhunës në familje, integrimi i personave me Aftësi të Kufizuar, mbrojtja e fëmijëve. Reforma në shërbimet e asistencës sociale, mbështetjes financiare dhe zhvillimi ekonomik përmes projekt programeve të pakove të qëndrueshmërisë dhe gjeneruese të të ardhurave për familjet me asistencë sociale, subvencionim dhe lirim nga taksat dhe shërbimet tjera administrative.

Perspektiva e barazisë gjinore do të merr vëmendjen e duhur në hartimin dhe implementimin e strategjisë, si e drejtë themelore, e përcaktuar si një parim fundamental në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Avancimi i perspektivës gjinore konsiderohet faktor i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik lokal, përmes fuqizimit ekonomik dhe ngritjes së mirëqenies sociale, duke përfshirë stabilitetin ekonomik të gruas. Strategjia do të synon pjesëmarrjen e grave dhe të rejave në aplikimin dhe përfitimin e subvencioneve të komunës në lidhje me bizneset dhe ndërmarrësinë, përfshirë investimin në ferma dhe zhvillimin rural. Poashtu, qasja në shërbime sociale cilësore dhe efektive për banorët e komunës që janë në nevojë do të përmirësohet dhe do të ofrohet në mënyrë të barabartë.

Ndihma sociale: Numri i familjeve që kanë përfituar nga skema e ndihmës sociale është zvogëluar nga 1,208 në janar, në 1,026 në dhjetor 2023. Skema sociale është e ndërtuar në kuadër të standardeve minimale, prandaj edhe ndihma sociale ofrohet për të mbuluar nevojat bazike jetësore, si dhe në mundësimin e krijimit të lehtësirave financiare të caktuara publike komunale falas.

6.10. Bujqësia në Komunën e Lipjanit

Komuna e Lipjanit, me pozicionin e saj gjeografik dhe kushtet klimatike, ofron një potencial të lartë për zhvillimin e bujqësisë dhe sektorit rural. Tokat bujqësore përbëjnë rreth 44% të sipërfaqes së përgjithshme të Komunës. Në vijim paraqitet një analizë e gjendjes së bujqësisë në komunë, duke përfshirë sipërfaqet e tokës bujqësore, sipërfaqet e mbjella, numrin e fermerëve dhe ekonomive bujqësore, kategorizimin e tokës, kullosat, bizneset e regjistruara dhe aktive, si dhe sfidat e sektorit privat.

Tabela 25. Toka bujqësore sipas shfrytëzimit

Kategoritë e shfrytëzimit	Hektarë
Tokë bujqësore e kultivuar	8,719
Tokë bujqësore e pa kultivuar	839
Livadhe dhe kullota	5,580
Gjithsej	15,138

Të dhënat mbi kategoritë e shfrytëzimit të tokës tregojnë se sipërfaqet më të mëdha janë të dedikuara për tokë bujqësore të kultivuar dhe livadhe e kullota. Në total, sipërfaqja e shfrytëzuar për bujqësi dhe aktivitete të lidhura është 15,138.91 hektarë. Toka bujqësore e kultivuar përfshin 8,719.07 hektarë, që përbën pjesën më të madhe të sipërfaqes totale bujqësore. Livadhet dhe kullotat përfshijnë 5,580.69 hektarë, duke treguar rëndësinë e tyre për blegtorinë dhe aktivitetet e tjera të lidhura. Toka bujqësore e pa kultivuar përfshin 839.5 hektarë, duke sugjeruar potencial për zgjerim të mëtejshëm të aktiviteteve bujqësore ose për përdorime të tjera. Në anën tjetër, edhe pse nëpër Komunën e Lipjanit kalon lumi Sitnica, në muajt e verës shpeshherë shterron por edhe ndotja e tij nga zbrazjet e kanalizimeve fekale dhe industriale pamundëson shfrytëzimin për qëllime të ujitjes.

6.10.1. Sipërfaqja e mbjellur dhe kulturat bujqësore

Sipërfaqja totale e tokës bujqësore në Komunën e Lipjanit është 15,139 hektarë. Tabelat në vijim tregojnë disa prej kulturave kryesore bujqësore dhe sipërfaqja e mbjellur për secilën dhe ofrojnë një pasqyrë të detajuar të sipërfaqeve të mbjellura me kulturat bujqësore dhe pemët drufrutore në Komunën e Lipjanit, duke dhënë një pasqyrë të rëndësishme të gjendjes dhe për planifikimin dhe zhvillimin e bujqësisë për vitet e ardhshme¹⁶:

¹⁶ Të dhënat e prezantuara nga drejtorati për bujqësi i Komunes së Lipjanit, 2024.

Tabela 26. Sipërfaqet e mbjellura me kulturat lavërtare

Kulturat Bujqësore	Sipërfaqja e mbjellur (hektar)
Grurë:	4,008.77
Misër:	4,350.30
Elb:	23.50
Tërshërë:	71.22
Kunguj:	95.35
Specat:	34.62
Patate:	150.69
Domate:	0.96
Hudhër:	0.35
Qepë	79.82
Lakër	6.52
Fasule	196.36
Shalqinjë	15.72
Kunguj misiri	17.06
Perime në serrë	6.86
Lulelakër	0.88
Pjepër	15.45
Kungulleshë:	0.37
Marullë:	0.42
BMA:	3.45
Totali	9,078.67

Tabela 27. Sipërfaqet e plantacioneve me pemë drufrutore

Kulturat Bujqësore	Sipërfaqja e mbjellur (hektar)
Mollë	47.10
Dardhë	2.40
Lajthi	14.65
Arrë	30.57
Kumbullë:	24.51
Aroni:	0.30
Dredhëz:	2.93
Mjedër:	2.71
Qersh:	2.28
Vreshtë:	4.59
Totali	132

Tabela 28. Sipërfaqet e mbjellura me pemë të imta

Kulturat Bujqësore	Sipërfaqja e mbjellur (hektar)
Mjedra	2.71
Dredhëza	2.93
Aronia	0.30
Totali	5.94

Burimi: Komuna e Lipjanit, 2023.

Numri i Fermerëve dhe Ekonomive Bujqësore

- Numri i fermerëve: 1650¹⁷
- Numri i ekonomive bujqësore: 5,500

Numri i Bizneseve të Regjistruara dhe Aktive

- Numri i bizneseve të regjistruara në sektorin bujqësor dhe pyjeve: 275
- Numri i bizneseve aktive: 118

Në Komunën e Lipjanit, sektori i bujqësisë luan një rol të rëndësishëm në ekonominë lokale, megjithatë, ekzistojnë sfida të dukshme në raportimin dhe operimin e tij, veçanërisht për shkak të operimin në suaza të informalitetit. Numri i fermerëve në komunë është 1650, por numri i ekonomive bujqësore është shumë më i madh, duke arritur në rreth 5,500. Ky dallim nënvizon ekzistencën e një sfere të gjerë të operimeve bujqësore që nuk janë plotësisht të regjistruara apo të monitoruara. Kjo pengon paraqitjen e një pasqyre të qartë dhe realiste të gjendjes në bujqësi, duke mbuluar potencialin dhe problemet që ky sektor mund të përjetojë në mënyrë më të saktë. Po ashtu, numri i bizneseve të regjistruara në sektorin bujqësor është 232, nga të cilat 215 janë aktive.

Mbështetja komunale për bujqësinë

Tabela 29. Mbështetja komunale për bujqësinë

Lloji i mbështetjes	2021	2022	2023	2024
Sera	440	-	50	233
Mekanizëm bujqësor freza			147	273
Mekanizëm bujqësor kositëse bari			12	
Mekanizëm bujqësor spërkatëse			204	

¹⁷ Sipas të dhënave nga programi i pagesave direkte të Komunes së Lipjanit, 2024.

Mekanizëm bujqësor shpërndarëse plehu			64	
Blegtori			13	
Hapje të puseve				95
Blegtorët				50

Burimi: Komuna e Lipjanit, Drejtorati për bujqësi, 2024.

Të dhënat mbi llojin e mbështetjes në sektorin bujqësor gjatë viteve 2021-2024 tregojnë një shpërndarje të ndryshme të resurseve për fusha specifike të bujqësisë dhe blegtorisë. Në vitin 2021, ndihma kryesore është përqendruar në serat (440 mbështetje), ndërsa në vitin 2022 nuk ka pasur mbështetje në këtë kategori. Në vitin 2023, mbështetja për serat rifillon, por me vetëm 50 njësi, ndërsa në vitin 2024 shënohet një rritje në 233 sera.

Ndihma për mekanizmat bujqësorë fillon më intensivisht në vitet 2023 dhe 2024, me një fokus në freza (147 njësi në 2023 dhe 273 njësi në 2024), spërkatës (204 njësi), si dhe ndihmë më të vogël për pajisje si kositëset e barit (12 njësi), dhe shpërndarës të plehrave (64 njësi). Në fushën e blegtorisë, mbështetja fillon në vitin 2023 me 13 njësi dhe më pas rritet në 50 njësi në vitin 2024. Hapja e puseve përfshihet vetëm në vitin 2024 me 95 njësi, që tregon një angazhim të ri për përmirësimin e burimeve ujore në sektorin bujqësor.

6.10.2. Sfidat e sektorit bujqësorë

Sektori privat në bujqësinë e Komunës së Lipjanit përballlet me disa sfida kyçe:

- **Humbja e tokës bujqësore:** Urbanizimi dhe ndryshimet në përdorimin e tokës po reduktojnë sipërfaqet e disponueshme për bujqësi, duke rrezikuar prodhimin e ushqimit.
- **Emigrimi dhe shpopullimi i zonave rurale:** Largimi i popullsisë nga zonat rurale drejt qyteteve apo jashtë vendit ka ulur fuqinë punëtore dhe ka dobësuar zhvillimin e bujqësisë lokale.
- **Fragmentimi i pronave bujqësore:** Prona të vogla dhe të ndara po e bëjnë të vështirë zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë, duke penguar investimet dhe modernizimin.
- **Ujitja e tokave bujqësore:** Mungesa e sistemeve të mirëmenaxhuara për ujitje është një pengesë për prodhimin e qëndrueshëm dhe të mjaftueshëm bujqësor.
- **Fuqia punëtore:** Zvogëlimi i fuqisë punëtore për shkak të emigrimit dhe mungesës së interesit nga të rinjtë po krijon vështirësi për ruajtjen dhe zhvillimin e aktiviteteve bujqësore.

- **Tregu dhe marketingu:** marketingu luan një rol të rëndësishëm për penetrim në tregje dhe rritje të shitjeve. Në këtë aspekt janë evidente mungesa e njohurive dhe shkathtësive të duhura.

Përkundër sfidave evidente, Komuna e Lipjanit ka një potencial të madh për zhvillimin e sektorit bujqësor dhe rural, falë resurseve të saj natyrore dhe klimës së favorshme. Megjithatë, për të realizuar këtë potencial, është e nevojshme të adresohen sfidat e përmendura dhe të përmirësohet infrastruktura dhe qasja në financim. Përmes investimeve të qëndrueshme dhe mbështetjes së vazhdueshme për fermerët, Komuna e Lipjanit mund të rrisë prodhimtarinë dhe konkurrueshmërinë e saj në tregjet lokale dhe rajonale.

6.11. Zhvillimi i turizmit dhe trashëgimia kulturore

Komuna e Lipjanit, e vendosur në qendër të Kosovës, poashtu ka një trashëgimi kulturore dhe arkitektoriale të pasur dhe potencial të madh për zhvillimin e turizmit. Të gjitha aspektet që ndërthurin historinë, kulturën dhe natyrën, përfaqësojnë një burim të rëndësishëm të identitetit të Komunës së Lipjanit dhe një bazë të fortë për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit kulturor, historik dhe natyror.

Turizmi është një prej sektorëve me potencial të madh për zhvillimin ekonomik të rajonit. Një nga iniciativat kryesore është promovimi i destinacioneve turistike përmes broshurave dhe videove promovuese, duke i bërë këto atraksione më të dukshme për vizitorët vendas dhe të huaj. Për më tepër, do të zhvillohet një qendër digjitale për turizmin, që do të ofrojë informacion të qasshëm dhe shërbime për turistët në mënyrë elektronike. Një tjetër element thelbësor është vendosja e sinjalistikës në vendet turistike, në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës, për të siguruar orientimin dhe qarkullimin e lehtë të turistëve në këto zona.

Komplekset memoriale dhe zonat e mbrojtura të trashëgimisë kulturore në Komunën e Lipjanit përbëjnë një pjesë të rëndësishme të identitetit historik dhe kulturor të rajonit. Ndër to, Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së në Kleçkë dhe Divjakë, si dhe ob Spitali Ushtarak i UÇK-së, përfaqësojnë pika kyçe të rezistencës së popullit gjatë luftës për çlirim, duke përfshirë memorialet dhe varrezat e dëshmorëve të UÇK-së dhe martirëve që ruajnë kujtesën e sakrificave të bëra për liri. Lista e plote e memorialeve jepet në vijim.

- Kompleksi Memorial i Zonës së Veçantë "Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së Kleçkë dhe Divjakë"

- Malet e Berishës;
- Memoriali i Martirëve në Sllovi,
- Memoriali i Martirëve Ribare i Vogël,
- Memoriali i Martirëve Hallaq i Vogël,
- Memoriali i Martirëve Dobrajë e Madhe;
- "Qendra Memoriale e Monumentale e Rambujes" në Shalë -Sadllar;
- Varrezat e Martirëve Vërshec-Blinajë;
- Memoriali i Dëshmorëve të kombit "Grackë e Vogël";
- Memoriali i masakrës "Masakra e Bujanit" - në Lipjan;
- Memoriali i "Dëshmorëve të Krojmirit",
- Restaurimi i shkollave të vjetra në Banullë dhe Dobrajë të Madhe.

Po ashtu, *zonat e mbrojtura të trashëgimisë kulturore* shtrihen në të gjitha periudhat historike, duke përfshirë Qytezën parahistorike në Gadimen e Epërme, një dëshmi e civilizimeve të hershme në rajon. Lokaliteti arkeologjik Ograje në Rubovc, që daton nga Antikiteti i vonë mesjetar, dhe qytezat në Kleqkë dhe Kodra e Gjyteit në Baicë, Gërmadhat e kishës së Shën Gjorit në Sllovi Gërmadhat e Manastirit mesjetarë Shën Gjergji në Sllovi Kishë varrezore e fshatit në Topliçan Gjurmët e Gjtetit të Janjevës Kisha e Shpalljes së Virgjëreshës, Lipjan tregojnë për zhvillimet historike dhe kulturore gjatë epokave të ndryshme. Për më tepër, rrënojat e kishave të vjetra dhe qyteza e Janjevës ofrojnë një pasqyrë të trashëgimisë religjioze dhe komuniteteve të ndryshme që kanë jetuar dhe kontribuar në zhvillimin e rajonit.

Trashëgimia arkitekturale përfshin një gamë të gjerë objektesh me vlerë historike, si kishat e vjetra, bunkerin e Luftës së Dytë Botërore në Vrellë, xhamitë dhe tyrbet, si dhe shtëpitë muzeale që përfaqësojnë epoka të ndryshme historike. Këto objekte janë të rëndësishme për ruajtjen e traditës dhe historisë lokale dhe kombëtare.

Në të njëjtën kohë, *trashëgimia natyrore* e komunës ofron pasuri të rralla dhe vende me vlera të mëdha natyrore, si Baica, Shala, Blinaja, Vrella, Qylaga, Gadima dhe Bujani. Këto zona ofrojnë peizazhe të bukura dhe janë destinacione të rëndësishme për ruajtjen e biodiversitetit, të cilat duhet të mbrohen dhe promovohen si pjesë e trashëgimisë së qëndrueshme të rajonit.¹⁸

Përmes draftit të planit të menaxhimit të Janjevës, do të përfshihen aktivitete specifike për të zhvilluar më tej atraksionet turistike natyrore dhe kulturore. Ndërkohë, vendet me potencial për turizmin malor janë gjithashtu një fokus kryesor, përveç

¹⁸ Përmbledhja është bazuar në planin Komunal për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe historike të Komunës së Lipjanit, 2017-2020.

destinacioneve të përmendura më parë, duke përfshirë destinacione të tilla si Shisharka, Plitkoviqi, Gryka e Shalës, Brusi, Terbofci, Kleqka, Divjaka dhe Gryka e Krojmiri. Këto zona do të promovohen si vende rekreative përmes planit zhvillimor komunal, duke shfrytëzuar potencialin e tyre natyror.

6.11.1. Vendet turistike të zhvilluara dhe me potencial të zhvillimit

Komuna e Lipjanit ka disa vende turistike të zhvilluara dhe të tjera me potencial për zhvillim:

- **Shpella e Gadimes:** Një atraksion natyror i njohur për formacionet e saj unike të gurëve dhe stalaktiteve.
- **Parku nacional i Blinajës** si rezervat i njohur në mbarë vendin.

Vende me potencial për zhvillim:

- **Muzeu i Trashëgimisë Kulturore:** Propozime për zhvillimin e një muzeu që do të prezantojë historinë dhe kulturën e Lipjanit.
- **Shtëpia Muze e Atë Shtjefën Gjeçovit në Janjevë.**
- **Kompleksi Memorial i Zonës së Veçantë "Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së Kleçkë dhe Divjakë".**
- **Qyteza e Janjevës,** si dhe vendet e lartëcekura me potencial në zhvillimin e turizmi rural dhe rekreativ.

6.11.2. Shfaqjet dhe performancat artistike në shtëpinë e kulturës

Shtëpia e Kulturës në Lipjan është një qendër kyçe për aktivitetet artistike dhe kulturore. Gjatë vitit të kaluar, janë mbajtur gjithsej 10 shfaqje dhe performanca artistike, duke përfshirë programe artistike për nder të festave ,por edhe programe artistike të organizuara prej shkollave të Komunës së Lipjanit. Aktivitete janë mbajtur edhe në hapsirat e Bibliotekës së Qytetit si shfaqje të filmave të ndryshëm, promovime të librave, takime, tryeza për të rinjë etj. Këto aktivitete kanë tërhequr një numër të konsiderueshëm vizitorësh dhe kanë kontribuar në pasurimin e jetës kulturore të qytetit.

Aktivitete kulturore dhe argëtuese ka pasur edhe në Sheshin „Adem Jashari “ dhe lokacione tjera publike .

Në Komunën e Lipjanit ekzistojnë 47 organizata jo-qeveritare që operojnë në fusha të ndryshme, duke përfshirë kulturën 3 OJQ , sportin 29 Klube dhe shoqata sportive, si dhe 15 OJQ rinore që mirren me mjedisin dhe edukimin Joformal të të rinjve . Këto

organizata luajnë një rol të rëndësishëm në promovimin e aktiviteteve rinore dhe kulturore, duke ofruar platforma për të rinjtë që të angazhohen dhe të zhvillohen.

6.11.3. Klubet sportive sipas llojit të sportit

Lipjani ka një strukturë të mirë organizuar të klubeve sportive, të cilat përfshijnë:

- Futboll: 4 klube meshkuj dhe 1 klub të femrave
- Basketboll: 2 klube
- Volejboll: 2 klube meshkuj dhe 1 klub të femrave
- Pingpong: 1 klub
- Hendboll : 1 klub i meshkujve dhe 1 klub i femrave
- Atletikë : 1 klub
- Shah : 1 klub i meshkujve dhe 1 klub i femrave
- Peshkatari: 1 klub
- Badminton: 1 klub
- Not: 1 klub
- Gjimnastikë: 1 klub
- Para Ping-Pong për Përsona me Aftësi të Kufizuara : 1 klub
- Para Boccia për Përsona me Aftësi të Kufizuara: 1 klub
- Para volejboli për përsona me Aftësi të Kufizuara: 1 klub
- Teqball: 1 klub
- Shkolla të futbollit: 4 shkolla
- Shogata e Pedagoqeve të Sportit Shkollor- Lipjan
- Futsall: 1 klub

Këto klube ofrojnë mundësi për të rinjtë dhe të rriturit të angazhohen në aktivitete sportive dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre fizike.

6.12. SWOT analiza

Analiza SWOT e paraqitur në vijim ofron një pasqyrë të aspekteve të ndryshme që ndikojnë në suksesin e implementimit të strategjisë së zhvillimit ekonomik të Komunës së Lipjanit. Si e tillë ka rezultuar në bazë të të dhënave të paraqitura në këtë dokument dhe të vlerësimeve të paraqitura edhe në dokumente tjera strategjike të Komunës, si draft PZHK 2030.

Tabela 30. SWOT analiza për Komunën e Lipjanit – Zhvillimi ekonomik

Përparësitë	Dobësitë
Pozicioni gjeografik: Komuna e Lipjanit është e pozicionuar në mënyrë strategjike në qendër të Kosovës, dhe në trekëndëshin e zhvillimit ekonomik, duke pasur qasje të lehtë në tregje. Burimet njerëzore: Rinia e popullsisë ofron potencial të lartë për zhvillim të shpejtë të aftësive dhe krijimin e një fuqie punëtore dinamike. Potenciali agroushqimor: Toka pjellore dhe tradita bujqësore mund të mbështesin zhvillimin e agroushqimit dhe industrisë së përpunimit të ushqimit. Infrastruktura rrugore, hekurudhore dhe ajrore: Lidhet mirë me autostradat kryesore, hekurudhen dhe ndodhet në afë të Aeroportit Ndë Adem Jashari, duke ofruar lehtësi në transportin e mallrave dhe njerëzve. Ekzistimi i zonave të veçanta turistike dhe ekonomike: Zona ekonomike e Qylagës (zona e Blinajës, shpellës së Gadimes, zona Kleqkë dhe Divjakë. Përvojë e mirë me zbatimin e strategjive: personeli i Komunës ka zhvilluar kapacitete solide për monitorimin dhe zbatimin e strategjive, përfshirë edhe strategjitë për zhvillim ekonomik.	Infrastruktura e kufizuar industriale: Zonat industriale me infrastrukturë dhe shërbime publike ende të kufizuara mund të pengojë investimet e mëdha. Papunësia: Papunësia e konsiderueshme, sidomos në mesin e të rinjve, është një pengesë për zhvillimin ekonomik. Barrierat nacionale dhe legislative: Ndryshimet e papritura në politika apo ligje mund të ndikojnë negativisht në klimën e biznesit dhe investimet afatgjata. Arsimimi jo adekuat në raport me tregun e punës: Mospërshtatshmëria e kurrikulave me nevojat e tregut të punës si dhe mungesa e trajnimeve adekuate për mësimdhënësit për teknologjitë e reja. Mungesa e investimeve të mjaftueshme: kufizimet buxhetore dhe mungesa e investimeve të nevojshme.

Traditë dhe përvojë industriale: minierat e dikurshme dhe industria prodhuese dhe perpunuese. Stabiliteti institucional: Komuna e Lipjanit karakterizohet me qeverisje stabile dhe të pergjegjsjme dhe qe siguron qasje të lehte në sherbime administrative dhe pa taksa komunale.	
Rreziqet	Mundësitë
Migracioni i trurit: Emigrimi i brendshëm fshat-qytet dhe emigracioni i jashtëm sidomos i të rinjve të kualifikuar për punësim jashtë vendit mund të krijojë mungesa të ndjeshme të fuqisë punëtore. Konkurrenca nga rajonet tjera: Komuna përballlet me konkurrencë të ashpër nga rajone të tjera të Kosovës ose nga vendet fqinje për të tërhequr investitorë. Ndryshimet klimatike dhe degradimi mjedisor: Fenomene të tilla si thatësisirat dhe ndotja mund të kenë ndikim negativ në bujqësi dhe ekonomi. Paqëndrueshmëria ekonomike dhe rreziqet globale: Ndikimet globale, siç janë recesionet ose krizat financiare, apo edhe situatat e jashtëzakonshme, mund të kufizojnë zhvillimin dhe investimet në rajon.	Zhvillimi i infrastrukturës së energjisë së gjelbër: Lipjani mund të përfitojë nga investimet në energji të rinovueshme dhe projekte të qëndrueshme. Ngritja e teknologjisë dhe inovacionit: Krijimi i të paktën një parku teknologjik dhe qendre inovacioni mund të rrisë konkurrencën e komunës në nivel nacional, si dhe krijimi i inkubatorit të biznesit. Tërheqja e investimeve të jashtme: Zhvillimi i marrëveshjeve me komuna tjera dhe me vende fqinje dhe rritja e interesit të investitorëve të huaj, posaçërisht diasporës. Turizmi dhe kultura: Promovimi i trashëgimisë kulturore dhe atraksioneve natyrore (zhvillimi i turizmit rural) mund të sjellë një rritje të qëndrueshme në turizëm dhe zhvillim ekonomik. Përmirësimi i cilësisë në arsim: Investimi në arsim dhe trajnime profesionale për të rritur kualifikimet e punonjësve përmes fuqizimit dhe themelimit të profileve arsimore deficitare, në përputhje me kërkesat e tregut. Avancimi i metutjetshëm i infrastrukturës rrugore.

Disa nga problemet zhvillimore në Komunën e Lipjanit

Për të analizuar dhe trajtuar problemet komplekse të zhvillimit të Komunës së Lipjanit, është e nevojshme të krijohet një pemë e problemit e cila pasqyron lidhjet ndërmjet shkaqeve dhe efekteve kryesore që ndikojnë në zhvillimin ekonomik, social dhe mjedisor të komunës.

Problemi kryesor në Komunën e Lipjanit është papunësia dhe potenciali i pashfrytëzuar ekonomik, që ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien e qytetarëve. Papunësia çon në varfëri të shtuar, ulje të të ardhurave për familjet dhe individët, si dhe rritje të emigracionit, veçanërisht në mesin e të rinjve. Ky fenomen kontribuon në një "ikje të trurit," duke dobësuar më tej mundësitë për zhvillim të qëndrueshëm brenda komunës.

Një tjetër sfidë kryesore është mungesa e investimeve të mjaftueshme sidomos nga sektori privat, si nga brenda ashtu edhe nga jashtë. Kjo pengon krijimin e vendeve të reja të punës dhe zhvillimin e infrastrukturës, duke e bërë zonën më pak tërheqëse për investitorët dhe duke kufizuar konkurrencën e bizneseve lokale. Pa investime në teknologji dhe modernizim, bizneset e vogla dhe të mesme e kanë të vështirë të konkurrojnë në tregje më të mëdha.

Një problem tjetër i rëndësishëm, si në tërë vendin, është mungesa fuqisë së kualifikuar punëtore. Fuqia punëtore është e papërgatitur dhe e pa kualifikuar mjaftueshëm për të përballuar kërkesat e tregut modern të punës, çka kontribuon në uljen e produktivitetit dhe inovacionit në sektorët kryesorë të ekonomisë. Kjo pabarazi në qasje ndaj punësimit dëmton më tej zhvillimin e komunës dhe rrit tensionet sociale.

Ndërkohë, mungesa e programeve të trajnimit dhe përmirësimit të aftësive i lë shumë grupe të cenueshme të papunësuar dhe pa shpresa për përmirësim. Mjedisi gjithashtu përballlet me disa sfida. Menaxhimi jo adekuat i mbeturinave, sidomos mungesa e riciklimit dhe ndotja e ajrit, ujit dhe tokës dëmtojnë jo vetëm shëndetin e qytetarëve por edhe atraktivitetin e komunës për investime dhe turizëm. Degradimi i mjedisit është një tjetër faktor që e bën zonën më pak tërheqëse për zhvillim të qëndrueshëm dhe inovacion.

7. Objektivat e Zhvillimit

Qëllimi primar i Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal është prezantimi i Komunës së Lipjanit si një rajon me potencial të madh zhvillimi dhe transformimi i saj në një ekonomi lokale që prioritetizojnë zhvillimin e përgjithshëm përmes sektorëve të saj kryesorë. Ndërsa tregtia dhe bujqësia luajnë një rol të rëndësishëm në këtë zhvillim, fokusi do të zhvendoset drejt sektorëve me investime të larta, inovacion, si dhe përpunim dhe prodhim.

Objektivat drejt këtij synimi kanë rezultuar nga strategjitë nacionale dhe lokale, sidomos nga SZHE 2019-2023 dhe nga Udhëzuesi për hartimin e strategjisë për zhvillim ekonomik lokal, kurse përmbajtësisht edhe nga Programi Nacional për Zhvillim Ekonomik Lokal 2030 si dhe dokumentet tjera strategjike lokale dhe qendrore.

Në përmbajtjen e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2024-2029, është vendosur një fokus i qartë dhe gjithëpërfshirës në zhvillimin e qëndrueshëm të Komunës së Lipjanit. Kjo strategji është ndërtuar mbi një vizion që synon transformimin e komunës në një qendër dinamike ekonomike dhe sociale, me rritje të qëndrueshme dhe të balancuar në të gjitha aspektet kryesore me kujdes ndaj ambientit dhe përmes aplikimit të ekonomisë qarkore.

Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal për Komunën e Lipjanit synon të adresojë sfidat kryesore që pengojnë rritjen ekonomike dhe përmirësimin e cilësisë së jetës. Në thelb, kjo strategji ka për qëllim transformimin e komunës në një rajon konkurrues dhe dinamik, duke krijuar mundësi për investime, rritjen e punësimit dhe përkrahjen e zhvillimit të sektorëve kyç.

Përmes objektivave të përcaktuara, strategjia synon nxitjen e investimeve dhe përmirësimin e infrastrukturës ekonomike, me fokus në rritjen e mundësive për punësim dhe fuqizimin e sektorit privat. Edukimi ekonomik dhe mbështetja për bizneset e vogla janë gjithashtu prioritetet kyçe, me synimin për të forcuar aftësitë sipërmarrëse dhe për të nxitur kulturën e biznesit në komunë.

Po ashtu, një fokus i veçantë është vendosur në përmirësimin e arsimit dhe infrastrukturës publike, duke përfshirë zgjerimin e rrugëve, përmirësimin e transportit, dhe zhvillimin e rrjeteve të ujësjellësit dhe kanalizimit. Strategjia gjithashtu synon zhvillimin e qëndrueshëm rural dhe rritjen e prodhimit bujqësor, ndërsa promovon turizmin dhe trashëgiminë kulturore, si dhe krijimin e infrastrukturës sportive për përfshirjen aktive të qytetarëve.

Këto objektiva të qarta synojnë të krijojnë një mjedis të favorshëm për zhvillimin afatgjatë të komunës, duke ofruar përfitime të prekshme për të gjithë qytetarët.

7.1. Objektiva e Përgjithshme 1: Nxitja e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm dhe konkurrues

Objektiva specifike 1: Rritja e mundësive për punësim gjithëpërfshirës dhe reduktimi i papunësisë

Treguesi 1: Rritja e numrit të vendeve të punës dhe përmirësimi i mundësive për punësim.

Treguesi 2: Forcimi i bashkëpunimit mes sektorit publik dhe privat në krijimin e mundësive të punës.

Objektiva specifike 2: Nxitja e investimeve dhe zhvillimi i aktivitetit ekonomik

Treguesi 1: Rritja e investimeve në sektorët kyç dhe zhvillimi i infrastrukturës ekonomike.

Treguesi 2: Mbështetje dhe zhvillimi i sektorëve të rinj dhe inovativë.

Objektiva specifike 3: Përmirësimi i edukimit ekonomik dhe ndihmës për NVM

Treguesi 1: Rritja e njohurive dhe aftësive në menaxhimin e bizneseve dhe financave.

Treguesi 2: Nxitja e kulturës së ndërmarrësisë dhe mbështetje për zhvillimin e NVM-ve.

Objektiva Specifike 4: Promovimi i Komunës së Lipjanit në Rajon

Tregusi 1: Promovimi i potencialeve zhvillimore

Tregusi 2: Tërheqja e investimeve të huaja dhe lokale

Objektivat dhe aktivitetet e mësipërme janë të dizajnuara për të rritur mundësitë për punësim, për të nxitur investimet dhe zhvillimin ekonomik, dhe për të mbështetur zhvillimin e bizneseve dhe edukimin ekonomik në Komunën e Lipjanit.

7.2. Objektiva e Përgjithshme 2: Përmirësimi i arsimit përmes zhvillimit të infrastrukturës, rritjes së cilësisë dhe sigurimit të qasjes për të gjithë

Objektiva specifike 1: Përmirësimi i infrastrukturës arsimore

Treguesi 1: Përfundimi i objekteve dhe hapësirave shkollore.

Treguesi 2: Avansimi i pajisjeve mësimore në shkolla.

Objektiva specifike 2: Përmirësimi i cilësisë së arsimit

Treguesi 1: Rritja e nivelit të trajnimit dhe kualifikimit të mësimeve.

Treguesi 2: Përmirësimi i metodave të mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Objektiva specifike 3: Rritja e qasjes në arsim për të gjithë

Treguesi 1: Ulja e numrit të nxënësve që braktisin shkollën.

Treguesi 2: Rritja e përfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta në sistemin arsimor.

Këto objektiva dhe aktivitetet e tyre përkatëse synojnë të adresojnë sfidat kryesore të identifikuara në sistemin arsimor të Komunës së Lipjanit, duke përmirësuar infrastrukturën, cilësinë e arsimit dhe qasjen në arsim për të gjithë nxënësit.

7.3. Objektiva e Përgjithshme 3: Përmirësimi i infrastrukturës publike në funksion të qytetarëve dhe bizneseve

Objektiva specifike 1: Përmirësimi i rrugëve dhe transportit

Treguesi 1: Rritja e gjatësisë së rrugëve të asfaltuara dhe të mirëmbajtura.

Treguesi 2: Përmirësimi i rrjetit të transportit publik.

Objektiva specifike 2: Zhvillimi i infrastrukturës së ujësjellësit dhe kanalizimit

Treguesi 1: Zgjerimi dhe përmirësimi i rrjetit të ujësjellësit.

Treguesi 2: Zgjerimi dhe përmirësimi i rrjetit të kanalizimit.

Objektiva specifike 3: Përmirësimi i infrastrukturës së ndriçimit publik dhe trotuareve

Treguesi 1: Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik.

Treguesi 2: Zgjerimi dhe përmirësimi i trotuareve.

Objektivat dhe aktivitetet përkatëse synojnë të adresojnë sfidat kryesore të identifikuara në sektorin e infrastrukturës të Komunës së Lipjanit, duke përmirësuar rrjetin rrugor, furnizimin me ujë dhe kanalizimin, si dhe ndriçimin publik dhe trotualet.

7.4. Objektiva e Përgjithshme 4: Zhvillimi i bujqësisë përmes rritjes së prodhimit, përmirësimit të infrastrukturës dhe promovimit të zhvillimit rural të qëndrueshëm.

Objektiva specifike 1: Rritja e prodhimit bujqësor

Treguesi 1: Zgjerimi i sipërfaqes së mbjellur dhe rritja e prodhimit për secilin kulturë bujqësor.

Treguesi 2: Rritja e numrit të fermerëve dhe ekonomive bujqësore aktive.

Objektiva specifike 2: Përmirësimi i infrastrukturës bujqësore

Treguesi 1: Përmirësimi i sistemit të ujitjes dhe kullimit në zonat bujqësore.

Treguesi 2: Zgjerimi i infrastrukturës për ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore.

Objektiva specifike 3: Promovimi i zhvillimit rural dhe qëndrueshmërisë

Treguesi 1: Rritja e numrit të bizneseve të regjistruara dhe aktive në zonat rurale.

Treguesi 2: Përmirësimi i cilësisë së jetës në zonat rurale përmes investimeve në infrastrukturë dhe shërbime.

Objektivat dhe aktivitetet përkatëse synojnë të përmirësojnë bujqësinë dhe zhvillimin rural në Komunën e Lipjanit, duke rritur prodhimin bujqësor, përmirësuar infrastrukturën dhe promovuar zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale.

7.5. Objektiva e Përgjithshme 5: Zhvillimi i turizmit, trashëgimisë kulturore, mbrojtjes së mjedisit dhe infrastrukturës sportive.

Objektiva specifike 1: Promovimi i turizmit dhe rritja e numrit të vizitorëve

Treguesi 1: Rritja e numrit të vizitorëve dhe të hyrave nga turizmi.

Treguesi 2: Përmirësimi i infrastrukturës turistike dhe shërbimeve.

Objektiva specifike 2: Ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore si dhe mbrojtja e mjedisit

Treguesi 1: Restaurimi dhe mirëmbajtja e objekteve historike, kulturore dhe realizimi i planeve dhe aktiviteteve në fushën e mbrojtjes së mjedisit.

Treguesi 2: Organizimi i aktiviteteve dhe shfaqjeve kulturore.

Objektiva specifike 3: Zhvillimi i infrastrukturës për sport dhe rekreacion

Treguesi 1: Ndërtimi dhe përmirësimi i objekteve sportive dhe parqeve.

Treguesi 2: Krijimi i mundësive për aktivitete rekreative dhe sportive për të rinjtë.

Këta objektiva dhe aktivitetet e tyre janë të dizajnuara për të promovuar turizmin dhe trashëgiminë kulturore në Komunën e Lipjanit, duke rritur atraktivitetin turistik, ruajtur dhe promovuar kulturën dhe historinë lokale, dhe duke përmirësuar mundësitë për aktivitete sportive dhe rekreative.

8. Burimet e Financimit

8.1. Financimet publike lokale

Burimet kryesore të financimit të strategjisë dhe të zhvillimit ekonomik të Komunës së Lipjanit vijnë nga taksat dhe buxheti i komunës. Buxheti komunal mbetet instrumenti kryesor për financimin publik lokal. Tabela në vijim përshkruan strukturën e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitet 2024 - 2027, duke shqyrtuar kategoritë ekonomike.

Tabela 31. Plan i buxhetor 2025 - 2027

Kategoritë ekonomike	2025	2026	2027
Paga e Mëditje	12,779,219	13,482,076	14,196,626
Mallra dhe Shërbime	3,761,000	3,836,220	3,912,944
Shërbime Komunale (Komunalit)	450,000	470,250	493,763
Subvencione dhe Transfere	1,120,000	1,176,000	1,270,080
Investimet Kapitale	6,786,819	7,151,296	7,521,750
Totali	24,897,038	26,115,842	27,395,163

Burimi: Komuna e Lipjanit (Planifikimi i Buxhetit 2025-2027), 2024

Kategoria e **Pagave dhe mëditjeve** paraqet një rritje të qëndrueshme nga viti 2025 në 2027, duke u rritur nga 12,779,219 € në 14,196,626 €. Kjo tregon një angazhim për përmirësimin e kushteve të punës dhe rritjen e investimeve në sektorin e punës.


Mallrat dhe shërbimet gjithashtu tregojnë një rritje të vazhdueshme, nga 3,761,000 € në vitin 2025 në 3,912,944 € në vitin 2027, e cila reflekton rritjen e kostove operative dhe nevojën për mallra dhe shërbime shtesë.

Shpenzimet komunale tregojnë një rritje të moderuar, duke kaluar nga 450,000 € në vitin 2025 në 493,763 € në vitin 2027, duke sugjeruar përpjekje për kontroll të kostove dhe përmirësim të shërbimeve publike. Rritja graduale e subvencioneve dhe transfereve, nga 1,120,000 € në vitin 2025 në 1,270,080 € në vitin 2027, tregon angazhimin për mbështetje sociale dhe zhvillim ekonomik, duke ofruar ndihmë financiare më të madhe për komunitetin çdo vit.

Kategoria e **investimeve kapitale** ka rritjen më të madhe, duke reflektuar një fokus të theksuar në projekte kapitale dhe zhvillime infrastrukturore. Shpenzimet rriten nga

6,786,819 € në vitin 2025 në 7,521,750 € në vitin 2027, duke treguar një angazhim për përmirësimin e infrastrukturës dhe realizimin e projekteve të mëdha në komunë. Këto të dhëna sugjerojnë një trend pozitiv për zhvillimin ekonomik dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës për banorët.

Figura 4. Trendi i investimeve kapitale



Pasi Komuna ka aprovuar planin financiar përmes KAB 2025-2027, aktualisht është në fazën e implementimit të planit vjetor për vitin 2024.¹⁹ Ky plan përfshin një sërë projektesh të ndryshme, ndër të cilat janë investimet kapitale dhe projekte të tjera të rëndësishme për zhvillimin lokal. Plani është në një dinamikë të kënaqshme të zbatimit dhe pritet që projektet e parapara të përfundojnë në kohën e duhur.

Plani buxhetor i Komunës së Lipjanit për vitet 2024-2027 tregon një trend pozitiv dhe rritës në të gjitha kategoritë ekonomike. Ky plan synon të mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe përmirësimin e shërbimeve publike, duke rritur investimet në infrastrukturë dhe mbështetjen financiare për qytetarët.

8.2. Financimet tjera

1. Projektet e bashkëfinancuara me nivelin qendror
2. Financime të donatorëve
3. Financime të sektorit privat

Investitorët privatë dhe donatorët do të luajnë një rol kyç në avancimin e zhvillimit ekonomik të Komunës së Lipjanit. Për të tërhequr këta investitorë, komuna do të ofrojë një sërë insentivash dhe lehtësirash. Këto burime financiare do të jenë thelbësore për zhvillimin ekonomik dhe social të komunës.

¹⁹ Plani i punës së Kryetarit dhe Drejtorateve komunale, 2024.

9. Monitorimi dhe Raportimi

Grupi Punues përgjegjës për monitorimin e zbatimit të strategjisë do të përcaktojë organizimin dhe strukturën e raporteve për të siguruar qartësi dhe efektivitet në raportim dhe analizë. Monitorimi i strategjisë realizohet nëpërmjet një procesi të vazhdueshëm dhe të strukturuar, i cili përqendrohet në matjen e përparimit kundrejt objektivave të përcaktuara nëpërmjet treguesve specifikë.

Çdo vit të zbatimit të strategjisë, përgatitet një raport i cili përfshin informata mbi shkallën e zbatimit të treguesve të vendosur, identifikon problemet që kanë dalë gjatë zbatimit dhe përshkruan masat korrigjuese të marra për t'i adresuar ato. Ky raport bazohet në analizat e progresit të dokumentit strategjik dhe sistemin e monitorimit të krijuar për këtë qëllim. Nëse identifikohen nevoja për përmirësime, bëhet një rishikim ose vlerësim i ndërmjetëm i planeve të veprimit për të siguruar që objektivat të përmbushen në mënyrë efektive.

10. Plani i Veprimt 2025-2027

1.1. Objektivi i përgjithshëm 1: Nxjtja e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm dhe konkurrues.							
Objektivi specifik 1.1	Treguesi (treguesit) për matjen e përmbushjes së objektivit			Gjendja bazë	Caku 2025	Caku 2027	
Rritja e mundësive për punësim gjithëpërfshirës dhe reduktimi i papunësisë	Treguesi 1: Rritja e numrit të vendeve të punës dhe përmirësimi i mundësive për punësim.			0%	20%	80%	
	Treguesi 2: Forcimi i bashkëpunimit mes sektorit publik dhe privat në krijimin e mundësive të punës.			0%	15%	80%	
Aktiviteti	Afati për zbatim	Kostoja Totale	Burimi i financimit (nëse financohet nga Komuna duhet të harmonizohet me KASH, nëse financohet nga donatori duhet të ceket)	Drejtoria udhëheqës	Drejtoria mbështetës	Rezultati	
1.1.1							
1) Krijimi i mundësive për trajnim dhe zhvillim profesional për të rritur aftësitë e fuqisë punëtore, me prioritet për vajzat dhe gratë.	2026	20,000.00	BK, Donatorët, Privat	DEZH	DKA, DB	Rritja e aftësive profesionale dhe mundësive të punës me prioritet për vajzat dhe gratë.	
	2027	30,000.00					
2) Trajnimi dhe aftësimi i grave në Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit.	2025	5,000.00	BK, Donatorët, Privat	DEZH	ZBGJ, DA, DKA	Përgatitja e grave për tregun e punës.	
	2026	5,000.00					
	2027	5,000.00					
1.1.2							
3) Krijimi i programeve të partneritetit ndërmjet komunës dhe bizneseve lokale për të përkrahur krijimin e vendeve të punës.	2025	1,000.00	BK, Donatorët, Privat	DEZH	DKA	Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit. rritja e numrit të të punësuarve për të rinjtë.	
	2026	2,000.00					
	2027	2,000.00					
4) Avancimi i bashkëpunimit me Agjencinë e Punësimit të Kosovës në mbështetje të punës së personave të papunë (subvencionimi i pagave).	2026	60,000.00	Komuna e Lipjanit, Donatorët	DEZH	APRK	Rritja e punësimit	

Objekti i specifik 1.2	Treguesi (treguesit) për matjen e përmbushjes së objektivit			Gjendja bazë	Caku 2025	Caku 2027
Nxitja e investimeve dhe zhvillimi i aktivitetit ekonomik	Treguesi 1: Rritja e investimeve në sektorët kyç dhe zhvillimi i infrastrukturës ekonomike.			0%	30%	85%
	Treguesi 2: Mbështetje dhe zhvillimi i sektorëve të rinj dhe inovativë.			0%	20%	75%
Aktiviteti	Afati për zbatim	Kostoja Totale	Burimi i financimit (nëse financohet nga Komuna duhet të harmonizohet me KASH, nëse financohet nga donatori duhet të ceket)	Drejtoria udhëheqës	Drejtoria mbështetës	Rezultati
1.2.1						
5) Organizimi i dy panairëve vendore në vitë me bizneset lokale	2025	2,000.00	BK, Donatorët	DEZH, DB	DKRS	Zhvillimi ekonomik lokal. Promovimi i bizneseve lokale.
	2026	3,000.00				
	2027	4,000.00				
